# PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR PERSONAT LGBTI

2021-2027

Tiranë, Dhjetor, 2021

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "© Këshilli i Evropës, viti i botimit".

Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Divizionit të Këshillit të Evropës për Përfshirjen dhe Luftën Kundër Diskriminimit, Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00, E-mail: Horizontal.Facility@coe.int
© Këshilli i Evropës, Dhjetor 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Europian sipas kushteve të miratuara.

Kopertina: Freepik

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të projektit "Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Shqipëri", në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019 – 2022", si edhe me asistencën teknike të UN Women, në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri" financuar nga Qeveria Suedeze. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

# Parathënie

Shqipëria ka bërë një progres të rëndësishëm në vitet e fundit lidhur me njohjen e të drejtave të personave LGBTI+, ka një komunitet të konsoliduar dhe aktiv në mbrojtje të të drejtave te tyre, ndërsa kanë vazhduar përpjekjet për ndërgjegjësimin e publikut.

Të drejtat dhe liritë themelore të individit garantohen që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pa përjashtim, dallim apo diskriminim për shkaqe individuale, përfshirë dhe orientimin seksual e shprehjen e identitetit gjinor. Por, është fakt në përditshmëri, personat LGBTI ndeshen me një sërë veprimesh paragjykuese e diskriminuese, shoqëruar dhe me një gjuhë të urrejtjes, dhunë e lëndime. Barazia de-jure jo gjithmonë respektohet dhe shoqërohet me drejtësi de-facto.

Beteja kundër steriotipeve e qëndrimeve paragjykuese patriarkale, është e gjatë dhe e vështirë, pasi synon në thelb ndryshimin e mendësisë, një proces ky që shpesh nuk përfundon edhe me edukimin ndër breza. Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi për të pranuar gjithkënd ashtu siç është dhe siç e ndjen të shprehë identitetin gjinor apo orientimin seksual, kërkon angazhimin e një sërë burimesh dhe ndërmarrjen e një sërë veprimesh të mirëkoordinuara.

Për këtë arsye përgatitëm dhe u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 700, dt 18.11.2021 "Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI, për vitet 2021-2027", i treti plan veprimi në nivel kombëtar me fokus mbrojtjen e të drejtave, ofrimin e shërbimeve cilësore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zvogëlimin e nivelit të papranueshmërisë së shoqërisë kundrejt personave LGBTI në Shqipëri, duke u fokusuar në masa më të forta kundër diskriminimit dhe krimit të urrejtjes ndaj personave LGBTI në të gjithë vendin.

Ky plan reflekton përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton krijimit të një shoqërie në themel të së cilës qëndron e drejta, merita dhe vlerat qytetare, sociale e profesionale e çdo individi, si dhe qeverisja në mënyrë të përgjegjshme, efikase, transparente, në interes të zhvillimit të vendit, duke luftuar korrupsionin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin.

Falenderojmë mbështetjen e dhënë nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës në kuadër të projektit "Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Shqipëri" dhe UNWOMEN në kuadër të Programit të Përbashkët "Ti japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri" të cilët na mbështetën me ekspertizë për përmbushjen me sukses të hartimit të këtij plani.

Zbatimi i këtij plani mbetet sfidë. Së bashku jemi të anazhuar të vazhdojmë punën si deri më sot.

**OGERTA MANASTIRLIU**
Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## Përmbajtja


| | |
|---|---|
| SHKURTIMET | 7 |
| PJESA I - KONTEKSTI STRATEGJIK | 9 |
| 1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik | 9 |
| 2. Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentat strategjike | 10 |
| 3. Arritjet, Analiza dhe Sfidat. | 15 |
| 4. Vizioni dhe misioni i dokumentit | 18 |
| 5. Metodologjia | 20 |
| PJESA II – QËLLIMET E POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PRIORITARE TË ZBATIMIT TË PKV | 22 |
| Politika I | 22 |
| Politika II | 25 |
| Politika III | 27 |
| PJESA III – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI | 28 |
| PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE | 30 |
| ANEKS 1. MATRICA E QËLLIMEVE TË POLITIKËS DHE TREGUESIT | 35 |
| ANEKS 2. MATRICA E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE DHE TREGUESIT | 36 |
| ANEKS 3. MATRICA E MASAVE DHE TREGUESIT | 39 |
| ANEKS 4. LOGJIKA E NDËRHYRJES, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE, AFATET KOHORE | 41 |
| ANEKS 5. PËRKUFIZIMET | 58 |

# SHKURTIMET

| | |
|---|---|
| AP | Avokati i Popullit |
| ASCAP | Agjenca e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DHF | Dhuna në Familje |
| ECRI | Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës |
| GKZK | Grupi Kombëtar për Zbatim dhe Koordinim |
| IA | Institucionet Arsimore |
| IAL | Institucionet e Arsimit të Lartë |
| IDAHOT | Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë |
| ILGA | Shoqata Ndërkombëtare e Lezbike, Gej, Biseksualë, Transgjinorë, Interseks |
| INSTAT | Instituti Shqiptar i Statistikave |
| KiE | Këshilli i Evropës |
| KMD | Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi |
| LGBTI+ | Lezbike, Gej, Biseksualë, Transgjinorë, Interseks + |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MK | Ministria e Kulturës |
| NJVV | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore |
| OJF | Organizatë Jo-Fitimprurëse |
| OSIGJ | Orientimi Seksual dhe Identiteti Gjinor |
| OZHQ | Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm |
| PBA | Plani Buxhetor Afatmesëm |
| PKIE | Plani Kombëtar i Integrimit Evropian |
| PKV | Plani Kombëtar i Veprimit |
| PSHSH | Policia e Shtetit Shqiptar |
| QKEV | Qendra Kombëtare për Edukimin në Vazhdim |
| RSH | Republika e Shqipërisë |
| SKBGJ | Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore |
| SHKP | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| ZVAP | Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar |

# Pjesa I
# **Konteksti strategjik**

## 1. HYRJA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT STRATEGJIK

"Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ 2021 - 2027" (këtu e në vijim "PKV LGBTI+ 2021 - 2027") u përgatit në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, sidomos ato të vetë personave LGBTI+ apo me fokus kryesor këtë grup të synuar, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, barazinë dhe mosdiskriminimin në Shqipëri.

I konceptuar si vijim dhe i lidhur logjikisht me Planin e mëparshëm Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020[1] "PKV LGBTI+ 2021 – 2027" përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo diskriminuese për të gjithë personat LGBTI+, të cilët kanë lirinë e qenit vetvetja; trajtohen në mënyrën e duhur, sipas standardeve të zbatueshme kombëtare të harmonizuara me ato ndërkombëtare; kanë qasje në shërbime publike cilësore apo shërbime mbështetëse të specializuara, të disponueshme në mbarë vendin dhe në përputhje me nevojat specifike të tyre; si dhe marrin pjesë aktivisht në të gjitha fushat e jetës, pavarësisht shprehjes së identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të seksit apo tërësisë së karakteristikave të tjera individuale të tyre.

"PKV LGBTI+ 2021 – 2027" është i treti plan veprimi në nivel kombëtar me fokus mbrojtjen e të drejtave, ofrimin e shërbimeve cilësore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zvogëlimin e nivelit të papranueshmërisë së shoqërisë kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri. Si i tillë ky PKV reflekton përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton krijimit të një shoqërie në themel të së cilës qëndron e drejta, merita dhe vlerat qytetare, sociale e profesionale e çdo individi, si dhe qeverisja në mënyrë të përgjegjshme, efikase, transparente, në interes të zhvillimit të vendit, duke luftuar korrupsionin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin.

"PKV LGBTI+ 2021 – 2027" lidhet drejtpërdrejt me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015-2020[2], me Programin Qeverisës 2017-2021[3], me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm[4]

[1] https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Plani_Kombetar_per_LGBTI.pdf
[2] https://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf
[3]https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf
[4]https://sdgs.un.org/goals

(OZHQ) dhe me Axhendën 2030[5]. Në masa apo veprime të caktuara të "PKV LGBTI+ 2021 – 2027" është mbajtur në konsideratë dhe është bërë referencë edhe në "Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 20231 – 2030"[6], si dhe në Strategjinë e Komisionit Evropian "Bashkimi i Barazisë: Strategjia e Barazisë për LGBTIQ 2020-2025", e para strategji e Komisionit për barazinë e LGBTIQ, publikuar më 11 nëntor 2020[7].

Gjithashtu "PKV LGBTI+ 2021 - 2027" u hartua duke u bazuar edhe në gjetjet dhe rekomandimet nga "Raporti i vlerësimit të Zbatimit të PKV për personat LGBTI në RSH 2016 – 2020", për rrjedhojë synon zgjerimin, thellimin dhe shtimin e masave të parashikuara dhe të pazbatuara plotësisht, apo edhe të zbatuara por që kërkojnë mbështetje për qendrueshmëri afatgjatë, sipas qëllimeve të politikave të përcaktuara më herët në PKV 2016-2020. Ndër të tjera, në raportin e vlerësimit të zbatimit të PKV 2016-2020 rekomandohet fokusimi në mënyrë të veçantë dhe në mbarë vendin tek personat LGBTI+ më në nevojë dhe të cilët përjetojnë diskriminim të shumëfishtë, si p.sh. personat transgjinorë dhe interseks.

Dokumenta të tjerë të rëndësishëm të mbajtur në konsideratë gjatë formulimit të objektivave specifikë, masave e veprimeve të parashikuara në "PKV LGBTI+ 2021 – 2027" janë edhe rekomandimet e përfshira në Raportin e Rishikimit Universal Periodik për Shqipërinë 2019[8], Raportin e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë 2020[9], Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020[10], Raportin e ILGA Evropë mbi Rishikimin Vjetor të Situatës së të Drejtave Njerëzore të LGBTI – kapitulli për Shqipërinë (2021)[11], etj.

## 2. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL SI DHE LIDHJA ME DOKUMENTAT STRATEGJIKE

### 2.1. Kuadri ligjor kombëtar

Vitet e fundit Shqipëria ka bërë përparime në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor kombëtar mbi të drejtat njerëzore, barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe harmonizimit të këtij kuadri me atë ndërkombëtar. Ndër ligjet kryesore që adresojnë çështjet e të drejtave, mbrojtjes dhe trajtimit të personave LGBTI+ në Shqipëri, përmendim:

**Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.** Njohja dhe respektimi i të drejtave ligjore të barabarta të personave LGBTI+ theksohen që në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, në nenin 18/2 të së cilës promovohen parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit: "Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale". Kushtetuta përcakton gjithashtu të drejta gjithëpërfshirëse për qytetarët (neni 15).

**Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar.** Që nga viti 2010, Shqipëria ka miratuar një ligj të përgjithshëm për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është përgjithësisht në përputhje me acquis e BE-së për barazinë. Ai "rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe

[5] https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf
[6] Miratuar me VKM nr. 400 datë 30.06.2021 botuar në Fletoren Zyrtare Nr.112, datë 15.07.2021
[7] https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combatting-discrimination/lesbian-gay-bi-trans-and-intersex-equality/lgbtiq-equality-strategy-2020-2025_en
[8] https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx
[9] https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240
[10] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf
[11] https://rainbow-europe.org/sites/default/files/annual-report/Annual-Review-Full-2021.pdf

mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër" (neni 1). Diskriminimi përkufizohet si "çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi." (neni 3). Ligji përcakton gjithashtu strukturën kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi, që është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në përmirësimet që iu bënë këtij Ligji me **Ligjin 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi"**, ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit, etj.

**Ligji nr. 10, datë 01.02.2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë".** Në përkufizimin e refugjatëve, Ligji për Azilin përmban edhe kategorinë e "një personi që i përket kategorisë së veçantë", duke e konsideruar këtë si bazë për dhënien e statusit të refugjatit atyre që kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale për shkak se janë persona LGBTI+ (Neni 3, pika 25).

**Ligji nr.10129, datë 11.5.2009, "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar**. Ligji për Gjendjen Civile, i ndryshuar në vitin 2020, ka si objekt kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë dhe përcaktimin e rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin e funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë. Në parim ky ligj e lejon ndryshimin e shënimit të gjinisë dhe të emrit në dokumentet zyrtare të gjendjes civile. Ligji parashikon se emrat mund të ndryshohen nëse kanë kuptim të papërshtatshëm (neni 2), si dhe në rastin kur ka gabime materiale në regjistër (neni 57/7). Ndryshimi duhet të certifikohet me anë të një akti juridik lëshuar nga një ent ligjor që është përgjegjës për këto akte (neni 9). Si emri ashtu edhe shënimi i gjinisë ndryshohet me vendim gjykate. Ndryshimi i emrit mbështetet në faktin se emri është i papërshtatshëm, ndërsa ndryshimi i shënimit të gjinisë bazohet në faktin se gjinia/seksi i personit është ndryshuar, që provohet me vërtetim nga mjeku. Shënimi i gjinisë nuk mund të ndryshohet me vetëdeklarim. Personi duhet të jetë në zotërim të një vendimi gjykate për të kërkuar njohjen zyrtare të emrit të ndryshuar dhe të gjinisë së ricaktuar. Ndryshimet pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (neni 57/10).

**Ligji nr. 22, datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social".** Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese" (Neni 10). Gjithashtu ky ligj përmban në Nenin 16 si kriter të përzgjedhjes së përfituesve "xv) individët që i përkasin komunitetit LGBTI+, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm, si dhe individëve të cilët kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji" duke garantuar kështu mbrojtje të veçantë për personat LGBTI+. Në lidhje me subvencionimin e qirave si instrument i programit të banesave sociale me qira, individët që i përkasin komunitetit LGBTI+, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor dhe përmbushin kriteret ligjore, do të kenë përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit.

**Ligji nr. 111, datë 14.12-2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".** Ky ligj ka si qëllim të tij të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë, të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organ përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike, krahas Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Gjykatave kompetente. Në lidhje me kategoritë e përfituesve të ndihmës juridike ligji nuk ka bërë asnjë parashikim të shprehur për personat LGBTI+ të cilët janë viktima të dhunës në familje, të abuzuar seksualisht dhe viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, etj. Por, në paragrafin *h* të Nenit 11 "personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi" gjejnë mbrojtje dhe personat që i përkasin komunitetit LGBTI+ në rastet e diskriminimit sipas legjislacionit në fuqi.

**Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.** Kodi i Punës ndalon diskriminimin në punësim dhe profesion për shkak të OSIGJ, duke e përkufizuar diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerë (neni 9). Ngacmimet morale, seksuale dhe komentet poshtëruese që cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e punonjësve janë të ndaluara (neni 32). Në rastin e diskriminimit për arsye të OSIGJ, punëdhënësi detyrohet të provojë se nuk ka bërë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, dhe në rastin e ngacmimit seksual, ligji e kalon barrën e provës tek punëdhënësi ose personi që pretendohet të ketë bërë ngacmimin. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Kodi i Punës përbëjnë bazën ligjore për mbrojtjen e personave LGBTI+ në fushën e punësimit. Ligjet ndalojnë diskriminimin në punësim për shkak të përkatësisë OSIGJ apo në një pakicë seksuale, përfshirë edhe lajmërimet për vende pune, proceset e përzgjedhjes dhe të rekrutimit, trajnimin e punonjësve në vendin e punës dhe ndërprerjen e kontratës.

**Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.** Pas ndyshimeve të Kodit Penal në vitin 2013 marrëdhëniet me persona të të njëjtit seks u dekriminalizuan dhe kryreja e krimeve me motive OSIGJ-të jepet si rrethanë rënduese në nenin 50, pika j. Kodi Penal kriminalizon gjuhën e urrejtjes për shkaqe të orientimit seksual (neni 265). Gjithashtu Kodi ndalon diskriminimin e personave nga ana e punonjësit me funksion shtetëror për arsye të OSIGJ (neni 253). Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur (meshkuj) dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet (neni 102/a). Marrëdhëniet seksuale dhe homoseksuale me dhunë nga eprorët apo punonjës të tjerë duke shpërdoruar detyrën, dënohen me burgim deri në tre vjet (neni 105), ndërsa me kërcënim për përdorimin e armës, me burgim deri në pesëmbëdhjetë vjet (neni 104). Ngacmimi seksual dhe sjellja seksuale që cenojnë dinjitetin personal të një personi, duke krijuar një mjedis armiqësor dhe degradues, dënohet me burgim deri në shtatë vjet (neni 108). Për sa i përket ndërhyrjeve të panevojshme mjekësore në personat interseks, Kodi Penal nuk përmban asnjë dispozitë, sepse kjo çështje trajtohet nga Ligji nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për Shëndetin Riprodhues", i ndryshuar, që ndalojnë çdo ndërhyrje pa pëlqimin paraprak të vetë personit, por pëlqimi në rastin e fëmijëve jepet nga prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë, sepse fëmijët janë të mitur dhe nuk kanë kapacitet ligjor.

**Ligji nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.** E drejta për kujdes shëndetësor është e garantuar në Kushtetutë. Kujdesi shëndetësor publik është përgjegjësi themelore e qeverisë dhe Ligji për Kujdesin Shëndetësor garanton të drejtën e shëndetit për të gjithë. Spitalet, klinikat dhe institucione të tjera shëndetësore, publike apo private, janë të hapura për publikun e gjerë. I gjithë dokumentacioni legjislativ në fushën e kujdesit shëndetësor është i përgjithshëm dhe nuk përmend në veçanti OSIGJ-të ose nevojat shëndetësore të personave LGBTI+. Duke qenë se baza ligjore parashikon kujdesin shëndetësor për të gjithë, personat LGBTI+ përfitojnë nga shërbimi shëndetësor mbi të njëjtat baza si qytetarët e tjerë.

**Ligji nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë".** Kodi i rishikuar i Procedurave Administrative i vitit 2015 ndalon çdo lloj diskriminimi për shkak, ndër të tjera, të gjinisë dhe OSIGJ. Ky ligj siguron mbrojtjen efektive të të drejtave të personave LGBTI+ (neni 17). Për më tepër, në rastet e pretendimeve për diskriminim për shkak të OSIGJ, ky ligj e kalon barrën e provës tek organi publik, siç parashikohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (neni 82).

**Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.** Ligji për Arsimin Parauniversitar i vitit 2012 ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe orientimit seksual (neni 5). Në Shqipëri, mbrojtja zyrtare në mjedisin shkollor garantohet nga dispozitat ligjore të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

## 2.2. Kuadri institucional

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** dhe **Avokati i Popullit** janë dy institucionet kryesore të pavarura të cilat ndër të tjera kanë përgjegjësi edhe adresimin në mënyrën e duhur të çështjeve të personave LGBTI+ në Shqipëri.

Në nivelin qendror, trajtimi i çështjeve të personave LGBTI+ koordinohet nëpërmjet **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** (MSHMS), konkretisht nëpërmjet **Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore,** si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kuptohet që përgjegjësinë për trajtimin e aspekteve të ndryshme të çështjeve të personave LGBTI+ në nivel qendror e kanë të gjitha ministritë e linjës, në varësi të misionit dhe fushës së tyre të veprimtarisë.

Në nivelin vendor, detyrimin dhe përgjegjësinë e trajtimit me prioritet, pa diskriminim dhe në përputhje me standardet e miratuara e legjislacionin në fuqi, për të gjitha çështjet që lidhen me personat LGBTI+, e kanë **Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore** në bashkëpunim me institucionet e tjera partnere vendore.

## 2.3. Lidhja e "PKV LGBTI+ 2021-2027" me dokumentat strategjikë

**a) Lidhja me SKZHI**

"PKV LGBTI+ 2021-2027" lidhet dhe harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II), konkretisht me Shtyllën 3: "Investimi në Kapitalin Njerëzor dhe Kohezionin Social", pikën 11.7. "Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse", e cila ka si vizion: "Një shoqëri gjithëpërfshirëse, që krijon akses të barabartë për të gjithë qytetarët në lidhje me shërbimet publike, duke lehtësuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri, pavarësisht nga niveli i të ardhurave, gjinia, mosha, aftësia e kufizuar, përkatësia etnike, orientimi seksual, vendbanimi apo besimi fetar".

**b) Lidhja me Programin e Qeverisë**

"PKV LGBTI+ 2021 – 2027" lidhet me Programin Qeverisës 2017-2021, sidomos në Prioritetin 3 'Shërbimet publike', veçanërisht Neni 3.2 "Arsimi, Rinia dhe Sporti" dhe 3.3 "Shëndetësia dhe Kujdesi Social". Çështja e mosdiskriminimit jepet qartësisht që në hyrje të këtij programi qeverisës, ku theksohet se: *"Duam t'ju sigurojmë që ... kjo qeverisje do të ushtrohet në mënyrë të përgjegjshme, efikase, transparente, në interes të zhvillimit të vendit, duke zgjeruar pjesëmarrjen dhe kontributin e çdo shqiptari në vendimmarrje, duke ndërtuar besimin e plotë tek e ardhmja moderne e Shqipërisë, duke luftuar korrupsionin, informalitetin, klientelizmin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin. "*

**c) Lidhja me Planin Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) dhe Acquis të BE-së**

"PKV LGBTI+ 2021-2027" lidhet me Kapitullin 19: Politika sociale dhe punësimi, Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore, Kapitullin 24: Drejtësia, liria dhe siguria, Kapitullin 26: Arsimi dhe kultura,, etj., dhe me detyrimet që vijnë nga MSA dhe faza ekzistuese e procesit të negocimit dhe integrimit të Shqipërisë.

Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023, përsa u takon personave LGBTI+, Seksioni 19.7 "Prioritetet", parashikon se prioritetet janë:

- Miratimi dhe zbatimi i Planit LGBTI+ 2021- 2027; dhe
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, profesionistëve të fushës.

**d) Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ)**

"PKV LGBTI+ 2021 – 2027" lidhet ngushtësisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm, konkretisht me:

***OZHQ 3*** "Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe", e në mënyrë specifike me target 3.7 "Deri në vitin 2030, do të sigurohet qasje universale në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, përfshirë planifikimin familjar, informacionin dhe edukimin, dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare"; si dhe target 3.8: "Arritja e mbulimit universal shëndetësor, përfshirë mbrojtjen e rrezikut financiar, aksesin në shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor dhe qasjen në ilaçe dhe vaksina thelbësore, efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë"

***OZHQ 4*** "Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë", e në mënyrë specifike me target 4.5 "Deri në vitin 2030, do të eliminohen pabarazitë gjinore në arsim dhe do të sigurohet akses i barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit profesional për personat e cenueshëm, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, popujt autoktonë dhe fëmijët në situata të cenueshme", si dhe me target 4.7 "Deri në vitin 2030, do të sigurohet që të gjithë nxënësit të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirë, ndër të tjera, përmes edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe mënyrë jetese të qëndrueshme, të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimit të një kulture paqeje dhe jo dhune, qytetarisë globale, vlerësimit të diversitetit kulturor dhe kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm".

***OZHQ 5*** "Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave", me fokus tek gratë dhe vajzat LBTI+, specifikisht me target 5.1 "Ndalimi i të gjitha formave të diskriminimit kundër të gjitha grave dhe vajzave kudo në botë" dhe target 5.2 "Eliminimi i të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, përfshirë trafikimin, abuzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit".

***OZHQ 8*** "Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, punësimit të plotë dhe produktiv, si dhe punës së denjë për të gjithë", specifikisht me target 8.5 "Deri në vitin 2030, të arrihet punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë gratë dhe burrat, përfshirë të rejat/rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë", si dhe target 8.8 "Mbrojtja e të drejtave të punës dhe promovimi i mjediseve të sigurta të punës për të gjithë punëtoret / punëtorët, përfshirë emigrantet / emigrantët, në veçanti gratë emigrante dhe ato në punë të pasigurt".

***OZHQ 10*** "Ulja e pabarazisë brenda dhe midis vendeve", e në mënyrë specifike me target 10.2 "Deri në vitin 2030, do të fuqizohet dhe promovohet përfshirja sociale, ekonomike dhe politike e të gjithëve, pavarësisht nga mosha, gjinia, paaftësia, raca, etnia, origjina, feja, statusi ekonomik ose çdolloj statusi tjetër", si dhe target 10.3 "Sigurimi i mundësive të barabarta dhe zvogëlimi i pabarazive të rezultateve, përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe veprimeve të përshtatshme në këtë drejtim"

***OZHQ 11*** "Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe të qëndrueshme", sidomos me target 11.1 "Deri në vitin 2030, do të sigurohet qasje për të gjithë në strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm, në shërbime thelbësore, si dhe do tëpërmirësohen lagjet e varfëra", si dhe target 11.7: "Deri në vitin 2030, do të sigurohet qasje universale në hapësira publike të sigurta, gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe të të gjelbra, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara."

*OZHQ 16* "Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet", sidomos me target 16.3 "Promovimi i zbatimit të ligjit në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë", si dhe target 16.7 "Sigurimi i vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet".

**e) Lidhja me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030.**
Veprimet e parashikuara në "PKV LGBTI+ 2021 – 2027" harmonizohen edhe me SKBGJ 2021 – 2030, miratuar në qeshor 2021, konkretisht me:
***Qëllimin e politikës I***: Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave **nga të gjithë grupet**, duke synuar një rritje dhe qendrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në dixhitalizim.
***Qëllimin e politikës II***: Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve **nga të gjitha grupet**, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.
***Qëllimin e politikës III***: Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
Siç theksohet edhe në vetë dokumentin e SKBGJ 2021 – 2030, për shkak të natyrës së ndërthurur (cross-cutting) të çështjeve gjinore, kudo në tekst ku haset formulimi "**nga të gjithë grupet"** pra si në qëllimet e politikave të sipërcituara, edhe në objektivat specifike, masat dhe aktivitetet e tyre, do të nënkuptohet: *nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, **LBTI+**, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj*. Prandaj, zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në secilin prej këtyre dy dokumentave ndikon në mënyrë të ndërsjellë dhe ndihmon në avancimin e çështjeve LGBTI+, si në terma ndërgjegjësimi dhe krijimi të një shoqërie pranuese e gjithëpërfshirëse, ashtu edhe kur flitet për profesioniste e profesionistë të trajnuar dhe shërbime mbështetëse të specializuara të disponueshme e cilësore, në përputhje me nevojat specifike të personave LGBTI+.

**f) Lidhja me Strategjinë e Komisionit Evropian "Bashkimi i Barazisë: Strategjia e Barazisë për LGBTIQ 2020-2025"**
"PKV LGBTI+ 2021 – 2027" harmonizohet edhe me Strategjinë e Komisionit Evropian "Bashkimi i Barazisë: Strategjia e Barazisë për LGBTIQ 2020-2025". Ky harmonizim vërehet kryesisht në:
***Shtyllën 1 "Ndalimi i diskriminimit ndaj personave LGBTIQ"***, e në mënyrë specifike në 1.1. Zbatimi dhe përmirësimi i mbrojtjes ligjore kundër diskriminimit; 1.2. Promovimi i përfshirjes dhe diversitetit në vendin e punës; 1.3. Luftimi i pabarazisë në arsim, shëndetësi, kulturë dhe sport.
***Shtyllën 2 "Garantimi i sigurisë për personat LGBTIQ"***, e në mënyrë specifike në 2.1 "Përforcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTIQ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës";
***Shtyllën 3: "Ndërtimi i shoqërisë gjithëpërfshirëse për personat LGBTIQ",*** e në mënyrë specifike me 3.3 "Përmirësimi i njohjes së identiteteve trans dhe jo binare, si dhe i personave interseks"

## 3. ARRITJET, ANALIZA DHE SFIDAT.

Situata në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e personave LGBTI+ në Shqipëri vitet e fundit ka shënuar përmirësime të ndjeshme.

**Raporti i ILGA Evropë mbi Rishikimin Vjetor të Situatës së të Drejtave Njerëzore të LGBTI – kapitulli për Shqipërinë (2021),** e rendit Shqipërinë në vendin e 27 me një pikëzim prej 33.2% nga 49 vende gjithsej, në tërësinë e fushave që vlerëson sa i takon respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave njerëzore të personave LGBTI+. Në ndarjen sipas fushave Shqipëria klasifikohet si në vijim:

- barazia dhe mosdiskriminimi – në vendin e 13 me pikëzim 56.92%
- familja - në vendin e 38 me pikëzim 3.75%
- gjuha dhe krimet e urrejtjes - në vendin e 7 me pikëzim 51.2%
- njohja ligjore e përckatimit të gjinisë dhe integritetit trupor – në vendin e 43 me 0%
- hapësira dedikuar shoqërisë civile – në vendin e 1 me 99.75%
- azili – në vendin e 35 me 0%

Në **Raportin e gjashtë të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë 2020**12, evidentohet se: Avokati i Popullit dhe KMD-ja e kanë bërë fjalimin e urrejtjes raciste dhe homo-/transfobike një temë të spikatur në punën e tyre, duke pranuar se ky problem duhet të zgjidhet në mënyrë efektive. Ndërsa Plani i Veprimit për personat LGBTI është një bazë e dobishme për të arritur ndryshime pozitive, janë veçanërisht të domosdoshëm hapat në lidhje me parandalimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë për personat LGBTI në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, dhe për ndërtimin e kapaciteteve në nivel bashkie, jashtë kryeqytetit. Personat LGBTI vazhdojnë të përballen me një numër problemesh në Shqipëri dhe shpesh hasin pengesa për barazi efektive. Sidoqoftë, vitet e fundit, situata e përgjithshme është përmirësuar paksa dhe problemet ekzistuese për anëtarët e komunitetit janë vendosur gjithnjë e më shumë në axhendën politike. Vetë ekzistenca e Grupit Kombëtar të Zbatimit dhe Koordinimit (GKZK), ngritur me Urdhër të Kryeministrit, është tregues i një angazhimi të fortë nga niveli më i lartë politik. Legjislacioni shqiptar nuk i njeh partneritetet mes personave të të njëjtës gjini. ECRI vëren me kënaqësi se në vitin 2018, Parlamenti shqiptar miratoi Kodin e Sjelljes që, ndër të tjera, ndalon deputetët të përdorin gjuhën e urrejtjes raciste dhe homo-/transfobike në Parlament, si dhe format e diskriminimit dhe stereotipit si në Parlament ashtu edhe në veprimtaritë jo-parlamentare. Në rast të shkeljeve, parashikohet që ndaj deputetit të zbatohen masa disiplinore. ECRI rekomandon që autoritetet shqiptare të sigurojnë një kornizë ligjore që u jep mundësinë çifteve të të njëjtit seks, pa asnjë lloj diskriminimi, që marrëdhënia e tyre të njihet dhe mbrohet, në mënyrë që të adresojnë problemet praktike që lidhen me realitetin shoqëror në të cilin ata jetojnë.

**Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020**[13], gjithashtu thekson se: Legjislacioni i Shqipërisë ndalon diskriminimin kundër personave lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë dhe interseks (LGBTI). Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për të mbrojtur personat LGBTI+ nga diskriminimi kur bëhet fjalë për qasjen në kujdesin shëndetësor, në arsim, drejtësi, punësim dhe strehim. Një Grup ndërministror përgjegjës për monitorimin e planit të veprimit është funksional, ndërkohë që oficerët e policisë, prokurorët dhe 'Nëpunësit e Barazisë Gjinore në ministritë e linjës janë trajnuar mbi parandalimin e diskriminimit për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual. Streha për personat LGBTI+, mbështetur edhe me fonde të shtetit prej vitit 2019, ka vijuar të ofrojë kujdes, mbështetje dhe avokim për persona të pastrehë LGBTI+. Gjithsesi ky shërbim mbetet kryesisht në varësi të mbështetjes së donatorëve. Ndërgjegjësimi dhe pranimi nga ana e publikut i personave LGBTI+ mbetet në nivel të ulët, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese vazhdon të jetë një problem në media, veçanërisht në media online. Dhuna dhe diskriminimi kundër personave transgjinorë është një fenomen shqetësues në vend.

**Raporti i Rishikimit Universal Periodik për Shqipërinë 2019**[14], përmban një tërësi rekomandimesh, ndër të cilat më të rëndësishmet lidhur me personat LGBTI+ renditen:

- Përmirësimi i përpjekjeve për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+, veçanërisht rishikimi i kurrikulave akademike mbi stereotipet gjinore dhe identitetin gjinor, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm 5 dhe 10;

[12] https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240
[13] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf
[14] https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx

- Forcimi i politikave për të luftuar veprat e dhunshme dhe krimet e urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, duke krijuar lidhje më të qendrueshme me shoqërinë civile dhe duke garantuar zbatimin e dispozitave ligjore për krimet e urrejtjes;
- Mbrojtja e personave LGBTI+ nga stigma dhe diskriminimi në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor, ndër të tjera, nëpërmjet trajnimeve për të gjithë personelin shëndetësor për të drejtat dhe rëndësinë e qasjes së barabratë të personave LGBTI+ në kujdesin shëndetësor;
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut të personave LGBTI+ duke luftuar diskriminimin strukturor;
- Zhvillimi i programeve në shkolla për të eleminuar ngacmimet ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve LGBTI+ dhe zbatimi i masave mbështetëse psikologjike për të zvogëluar përqindjet e braktisjes së shkollës nga ana e tyre;
- Ndryshimi i Kodit të Familjes për të siguruar njohjen ligjore për çiftet e të njëjtit seks dhe miratimin e dispozitave që lejojnë njohjen ligjore të gjinisë së individëve trans; etj.

Nga një vlerësim i përgjithshëm i kuadrit ligjor, rezulton se ka disa ligje të cilat kanë nevojë për rishikim dhe përmirësim, bazuar edhe në rekomadimet e dhëna nga raportet dhe institucionet e sipërcituara, të tilla si:

**Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 "Kodi i Familjes", i ndryshuar.** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njeh të drejtën e martesës dhe familjes për të gjithë (neni 53), ndërsa Kodi i Familjes e përkufizon martesën si një institucion ndërmjet një burri dhe një gruaje, gjë që në thelb ndalon martesat brenda seksit (neni 163). Në lidhje me bashkëjetesën nuk ka ndonjë ndalim për bashkëjetesat homoseksuale.

**Ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 "Për Birësimin", i ndryshuar.** Partnerët e të njëjtit seks nuk mund të birësojnë fëmijë së bashku, për shkak se një i mitur nuk mund të birësohet nga më shumë se një person përveç rastit kur këta persona janë bashkëshortë, që do të thotë burrë dhe grua (neni 242). Sipas Ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 "Për Birësimin", i ndryshuar (Neni16/2), personi që bën kërkesë për birësim fëmije duhet të plotësojë kushtet sipas Kodit të Familjes, që do të thotë të jetë në marrëdhënie bashkëshortore (neni 242).

Nga procesi i **Vlerësimit të Zbatimit të PKV për personat LGBTI në RSH për periudhën 2016 – 2020**, rezulton se:

- Pavarësisht përmirësimeve të ndjeshme në periudhën 2016-2020, jo të gjithë personat LGBTI+ në mbarë vendin janë trajtuar apo kanë përfituar njëlloj. Përmirësimet vërehen më së shumti tek personat LGBTI+ në kryeqytet, Tiranë, dhe kryesisht tek persona lezbike, gej dhe biseksualë. Ndërsa personat LGBTI+ të cilët jetojnë jashtë Tiranës dhe në veçanti, personat transgjinorë dhe interseks kanë parë më pak progres.

- Përveç adresimit të nevojave aktuale të personave LGBTI+ në Shqipëri, është gjithashtu e rëndësishme që Shqipëria të përmbushë kushtet lidhur me të drejtat e njeriut të personave LGBTI+ për anëtarësim në BE, rekomandimet e ECRI të KE dhe rekomandimet dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse.

- Është e rëndësishme që politikat qeveritare, përfshirë edhe PKV-të, jo vetëm të miratohen, por edhe të zbatohen dhe të financohen siç kërkohet, duke përmirësuar mangësitë në legjislacion dhe duke ndërmarrë masa më të forta kundër diskriminimit dhe krimit të urrejtjes ndaj personave LGBTI+ në të gjithë vendin.

- Gjatë periudhës 2016 - 2020 është shpenzuar një buxhet shumë i vogël për zbatimin e PKV krahasuar me atë që do të duhej të shpenzohej dhe është vënë re mungesë e burimeve financiare e njerëzore, veçanërisht në fundin e vitit 2019 dhe gjatë vitit 2020, si pasojë e situatës së emergjencës civile (tërmeti i nëntorit 2019) dhe gjendjes së fatkeqësisë natyrore (COVID-19). PKV e ardhshme rekomandohet të formulohet qartë dhe institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e PKV të venë në dispozicion burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

- Sa u përket ndryshimeve legjislative, janë bërë hapa pozitivë për ndihmën juridike dhe strehimin social. Ndryshimet e bëra në fund të 2020 në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi[15], parashikuan përkufizimin lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe forma të tjera diskriminimi në përputhje me standardet e Këshillit të Europës. Nevojiten ndryshime në legjislacionin që trajton në mënyrë specifike çështjet e ndjeshme ndaj personave LGBTI+, siç janë Kodi i Familjes, Kodi Penal dhe Ligji i Birësimit që janë në pritje, dhe si dhe Ligji për Njohjen e Idenditetit Gjinor. Këtyre nismave legjislative duhet t'u jepet prioritet në periudhën e ardhshme, me qëllim që legjislacioni shqiptar të përputhet me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së.
- Në lidhje me fuqizimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë dhe të punonjëseve e punonjësve të sistemit shëndetësor, arsimor, të fushës së punësimit, mbrojtjes, drejtësisë, etj., pavarësisht trajnimeve të zhvilluara nga MSHMS, në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore e OJF, nevojitet sërish vëmendje dhe planifikim i veprimeve në kjëtë drejtim, duke synuar përgatitjen dhe përfshirjen e moduleve të trajnimit mbi çështjet LGBTI+ në kurrikulat e ASPA, në institucionet e arsimit të lartë, në Shkollën e Magjistraturës, etj. Ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve duhet të shtrihet gjerësisht edhe në NJVV dhe institucionet partnere vendore. Duhet të krijohet shkëmbimi i rregullt midis policisë, gjyqësorit, KMD, AP dhe OJF për të rritur besimin dhe gatishmërinë për të raportuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+.
- Nevojitet të tregohet një vëmendje më e madhe dhe të planifikohen masa e veprime specifike në PKV e re për LGBTI+ 2021 – 2027, të cilat të fokusohen në fushën e punësimit, arsimit, shëndetësisë, zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor të përmirësuar me fokus çështjet LGBTI+, etj. P.sh. në zbatim të ndryshimeve të Ligjit nr.79/2017 "Për sportin", i ndryshuar, duhet të merren masa për përmirësimin e aksesit të personave LGBTI+ në qendrat sportive, klubet, federatat sportive, etj. Ose, duhet të planifikohet dhënia e informacionit të duhur në lidhje me protokollin për fëmijët interseks miratuar nga MSHMS në korrik 2020. Gjithashtu, bazuar në mësimet e nxjerra nga vështirësitë që ndeshën personat LGBTI+ gjatë periudhës së karantinës për shkak të Covid-19, duhet të planifikohen veprime për të përmirësuar aksesin dhe disponueshmërinë e shërnbimeve të kujdesit shëndetësor për personat LGBTI+. Personat që punojnë në repartin e lindjes ose në gjinekologji duhet të udhëzohen në mënyrë specifike për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për personat transgjinorë. Po kështu duhet të përmirësohet aksesi personave LGBTI+, në testime plotësisht anonime për SST, etj.
- Sa i përket strehimit, vlerësohet përfshirja e personave LGBTI+ si grup përfituesish në Ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social" dhe zbatimi i këtyre ndryshimeve për disa persona LGBTI+, kryesisht në Tiranë. Është e rëndësishme të vijohet me zbatimin e këtyre ndryshimeve ligjore në rang vendi. Po kështu, shërbimet mbështetëse të specializuara të tilla si Qendra STREHA, duhet të kenë një mbështetje të qendryueshme financiare, kryesisht nga buxheti i shtetit.
- Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit të opinionit publik për pranimin dhe gjithëpërfshirjen e personave LGBTI+, si dhe respektimin e të drejtave të tyre njerëzore, është gjithashtu domosdoshmëri dhe duhet të mundësohet përmes planifikimit të aktiviteteve konkrete në këtë drejtim.

## 4. VIZIONI DHE MISIONI I DOKUMENTIT

**Vizioni**

"Një shoqëri gjithëpërfshirëse që u mundëson personave LGBTI+ lirinë e të qenit vetvetja, mosdiskriminim, trajtim, mundësi dhe qasje të barabartë në shërbime publike cilësore e të përshtatura sipas nevojave, si dhe pjesmarrje aktive në të gjitha fushat e jetës pavarësisht nga shprehja e identitetit gjinor, orientimi seksual, karakteristikat e seksit apo nga tërësia e karakteristikave të tjera individuale të tyre".

[15] Ligj Nr.124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

**Misioni**

"PKV LGBTI+ 2021-2027" ka një kohëzgjatje 7 (shtatë) vjeçare brenda së cilës synohet që në përputhje edhe me vizionin e paraqitur më sipër, të krijohet një mjedis gjithëpëfshirës, pranues dhe jo diskriminues për të gjithë personat LGBTI+, pavarësisht shprehjes së identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të seksit apo karakteristikave të tjera individuale të tyre. Kjo nënkupton trajtimin në mënyrën e duhur sipas standardeve të zbatueshme e të kërkuara kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet shërbimeve cilësore dhe përmes burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, në përputhje me tërësinë e nevojave dhe duke u kushtuar vëmendje të veçantë personave LGBTI+ të cilët pësojnë diskriminim të shumëfishtë dhe janë më pak të pranuar. Synimi është përballja dhe trajtimi i elementëve paragjykues e diskriminues, krijimi i një mjedisi të sigurt, të pranueshëm e gjithëpërfshirës, si dhe avancimi drejt barazisë për personat LGBTI+, përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, politikave, shërbimeve dhe ndërtimit të kapaciteteve të duhura profesionale".

*Parimet kryesore* **që udhëheqin "PKV LGBTI+ 2021-2027" janë:**

**Parimi për të gëzuar universalisht të drejtat e njeriut.** Të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta. Qeniet njerëzore të të gjitha orientimeve seksuale, të të gjitha shprehjeve të identiteteve gjinore, të të gjithga karakteristikave të seksit apo tërësisë së karakteristikave të tjera individuale, kanë të drejtën e gëzimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut.

**Parimi për të gëzuar mbrojtje nga shteti**. Të gjithë personat në një shoqëri, pavarësisht nga orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinor, karakteristikat e seksit, apo karakteristika të tjera individuale, kanë të drejtë të gëzojë mbrojtjen e shtetit nga dhuna, diskriminimi dhe dëmtime të tjera, qoftë nga ana e punonjëseve apo punonjësve të shtetit, qoftë nga ndonjë individ apo grup i caktuar.

**Parimi i mosdiskriminimit si pikënisje bazë në ofrimin e shërbimeve.** Të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë për trajtim të barabartë pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, feja, kombësia, etnia, orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinor, karakteristikat e seksit apo çdo karakteristikë tjetër. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi[16].

**Parimi i afirmimit/pohimit dhe respektit për identitetin personal**. Afirmimi është një mënyrë e të kuptuarit dhe të krijuarit të hapësirave të sigurta për të gjithë njerëzit. Afirmimi është i rëndësishëm gjatë gjithë jetës. Personat LGBTI+ shpesh kanë frikë se mund të abuzohen ose se nuk do të mund të marrin kujdes sipas standardeve nëse janë të hapur për identitetin e tyre. Kjo frikë mund t'i shtyjë ata të fshehin orientimin seksual ose identitetin gjinor, duke i shkëputur kështu nga komuniteti i tyre dhe nga afirmimet e rëndësishme për historinë dhe përvojën e tyre. Përqendrimi në afirmim na lejon të kuptojmë se çfarë mund të bëjë mungesa e tij për ndjenjën e vetvetes të një personi dhe cilësinë e kujdesit të tij - veçanërisht kur njerëzit rriten dhe kanë nevojë për marrëdhënie të reja dhe forma të ndryshme të kujdesit[17]. Pra, koncepti i afirmimit është një formë aktive e shprehjes së identitetit dhe në kontekstin e personave LGBTI+ ai lidhet sidomos me problematikën e "fshehjes" së tyre apo statistikave rreth tyre, në shërbime të ndryshme.

---

[16] Sipas Ligjit 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, neni 1 dhe 3. Shiko: https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji%2010221_%202010%20per%20mbrojtjen%20nga%20%20diskriminimi.pdf

[17] https://scholars.org/contribution/affirmation-way-understand-and-create-safe-spaces-all-people

**Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale**. Të dhënat personale të personave LGBTI+ duhet të mbahen konfidenciale dhe të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Profesionistet dhe profesionistët e angazhuar në ofrimin e shërbimeve të ndryshme për personat LGBTI+ kanë detyrim ruajtjen e konfidencialitetit edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

**Parimi "Mos lëndo" dhe vendosja e personit LGBTI+ në qendër të shërbimit**. Parimi 'Mos lëndo" sjell në vëmendje faktin që ndihma e ofruar dhe mënyra se si administrohet, mund të shkaktojë dëm ose mund të forcojë kapacitetet e personave LGBTI+. Prandaj është shumë e rëndësishme për ofrueset dhe ofruesit e shërbimeve në të gjitha fushat, të arrijnë të kuptojnë kontekstin në të cilin ka nevojë të ofrohet ndihmë dhe më pas të veprojnë në bazë të të kuptuarit të këtij konteksti, për të shmangur pasojat negative në veprimet e tyre. Gjithashtu, në filozofinë e ofrimit të shërbimeve përmes qasjesve shumë-disiplinare të koordinuara, duhet të mbahet në konsideratë rëndësia e pasjes së personave LGBTI+ në qendër të sistemit dhe reagimeve – me fjalë të tjera, ofrimi i shërbimeve në bazë të nevojave dhe prioriteteve të tyre. Lidhur ngushtësisht me këtrë parim është edhe **parimi i sigurisë, dinjitetit, diversitetit dhe aksesit në shërbime.** Të gjitha ndërhyrjet për personat LGBTI+ për ngritjen apo ofrimin e çdo shërbimi, duhet t'i japin përparësi sigurisë dhe dinjitetit të përdoruesve të shërbimit dhe personelit. Gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve është e rëndësishme të respektohet diversiteti dhe aksesi për të gjithë personat LGBTI+ në varësi edhe të nevojave të tyre. Çdo plan individual që përgatitet në qendrat e shërbimeve, me qëllim adresimin e situatës së një personi LGBTI+ në nevojë për mbështetje dhe ndihmë, duhet patjetër të përmbajë si element kryesor sigurinë e tyre.

## 5. METODOLOGJIA

Siç është shpjeguar në nënkapitullin 2, kuadri ligjor dhe institucional në fuqi që udhëheq përgatitjen e këtij Plani Kombëtar Veprimi, përputhet plotësisht me dokumentat strategjikë në nivel kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, për rrjedhojë edhe vizioni, qëllimet e politikws dhe objektivat specifikë të parashikuar në "PKV LGBTI+ 2021-2027" përputhen plotësisht me këta dokumenta strategjikë.

Nisma për hartimin e këtij dokumenti strategjik u ndërmor nga institucioni kryesor përgjegjës në nivel qendror për koordinimin e veprimeve dhe trajtimin e çështjeve LGBTI+, pra Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila punoi ngushtësisht me Grupin Ndërinstitucional të Punës (GNP) të përbërë nga përfaqësuese dhe përfaqësues të ministrive kryesore të linjës. Mbështetja dhe orientimi bazuar tek gjetjet apo rekomandimet e disa raporteve ndërkombëtare, të tilla si: Raporti i ILGA Evropë mbi Rishikimin Vjetor të Situatës së të Drejtave Njerëzore të LGBTI – kapitulli për Shqipërinë (2021), Raporti i gjashtë i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë 2020, Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020, apo Raporti i Rishikimit Universal Periodik për Shqipërinë 2019, ishin tepër ndihmuese. Formulimi i objektivave, masave dhe veprimeve u bazua edhe në Strategjinë e Komisionit Evropian " Bashkimi i Barazisë: Strategjia e Barazisë për LGBTIQ 2020-2025", si dhe në Raportin e vlerësimit të zbatimit të "PKV LGBTI+ 2016 – 2020".

Gjithashtu vlen të përmendet mbështetja e ofruar nga Këshilli i Evropës përmes një grupi ekspertesh[18] të cilat lehtësuan punën e GNP në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, si dhe mbështetja e veçantë dhe asistenca

[18] Grupi i eksperteve përmes të cilave KE i ofroi mbështetje dhe asistencë teknike MSHMS gjatë gjithë procesit të hartimit të "PKV LGBTI+ 2021-2027" përbëhej nga: Marije Cornelissen dhe Ardjana Shehi, të cilat përgatitën raportin e Vlerësimin e Zbatimit të PKV LGBTI 2016-2020, si dhe lehtësuan punën e GNP për përgatitjen e draft "PKV LGBTI+ 2021 – 2027". Kostimi i dokumentit të përgatitur u realizua me mbështetjen e KE përmes angazhimit të ekspertes Albana Ahmeti.

teknike e ofruar nga UN Women Shqipëri për rishikimin e plotë dhe përgatitjen e variantit përfundimtar të "PKV LGBTI+ 2021 – 2027"[19].

Gjatë punës për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit janë realizuar një sërë konsultimesh me aktorë dhe bashkëpunëtorë të rëndësishëm në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, ku rol të rëndësishëm kanë luajtur komentet dhe sugjerimet e përcjella nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, sidomos ato të specializuara në çështjet LGBTI+, organizatat ndërkombëtare, etj.
Gjithashtu, ky dokument është publikuar për konsultim publik më datë 23 korrik 2021 në linkun me poshtë: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/406

[19] Për këtë qëllim UN Women angazhoi eksperten Monika Kocaqi e cila rishikoi PKV në tërësi, si pjesën narrative, formulimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve, ashtu edhe pasaportën e indikatorëve dhe përgatiti vartiantin përfundimtar të këtij dokumenti.

# Pjesa II
# Qëllimet e politikave, objektivat specifikë dhe masat prioritare të zbatimit të PKV

"PKV LGBTI+ 2021-2027" përbëhet nga 3 (tre) Qëllime të Politikave:

I. Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specfike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane/ndërkombëtare.

II. Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë.

III. Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri

Arritja e këtyre qëllimeve të politikave kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministritë e linjës, institucionet publike qendrore, në nivel qarku e vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile sidomos ato të specializuara në çështjet LGBTI+, organizatat ndërkombëtare, medias, akademisë, si dhe të të gjithë aktorëve të tjerë që zbatojnë politika të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e të drejtave të personave LGBTI+. Një nevojë e domosdoshme dhe e vazhdueshme është gjetja e mekanizmave të duhur dhe të përshtatshëm që sigurojnë një bashkëpunim të fortë dhe efektiv ndërinstitucional, si në drejtimin horizontal ashtu dhe atë vertikal.

**Politika I**

**Qëllimi i Politikës I - Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specfike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane/ndërkombëtare.**

Bazuar në Fushën e Politikës 3 "Aksesi në shërbime" të PKV-së së mëparshëm 2016-2020, ky qëllim i politikës është zgjeruar më tej, duke synuar përmirësimin e aksesit të personave LGBTI+ në të gjitha shërbimet, sidomos në shërbimet mbështetëse të specializuara. Fuqizimi i kapaciteteve të ofruesve të këtyre shërbimeve për njohjen dhe trajtimin në mënyrën e duhur të rasteve të personave LGBTI+, si dhe ofrimi i shërbimeve

miqësore, profesionale, të standardizuara dhe efektive shëndetësore, në arsim, punësim, etj., janë vlerësuar gjithashtu si pjesë e rëndësishme e këtij qëllimi të politikës I.

Treguesit kryesorë të impaktit nën këtë qëllim të politikës janë:

- Numri i personave LGBTI+ të cilët përfitojnë shërbime mbështetëse të specializuara miqësore e sipas standardeve
- Numri i personave transgjinorë dhe interseks të trajtuar në aspektin shëndetësor sipas protokolleve shëndetësore, të miratuara në përputhje me standardet evropiane/ndërkombëtare.

Për arritjen e këtij qëllimi të politikës I, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë, në partneritet me institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile, do të fokusohen në këto objektiva specifikë:

| | |
|---|---|
| Objektivi specifik I.1 | Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+. |
| Objektivi specifik I.2 | Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim |
| Objektivi specifik I.3 | Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin. |
| Objektivi specifik I.4 | Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë personat LGBTI+ larg tregut të punës si dhe rritja e aksesit të tyre për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë). |

Përmbushja e këtyre objektivave specifikë do të sjellë një përmirësim në mënyrën se si personat LGBTI+ marrin shërbime të ndryshme qofshin këto publike, por edhe në trajtimin me shërbime mbështetëse të specializuara, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

Kështu më konkretisht, nën **objektivin specifik I.1 "Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+."** janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

i. Shërbime mbështetëse të specializuara të aksesueshme dhe disponueshme edhe nga personat LGBTI+ në mbarë vendin.

ii. Profesioniste dhe profesionistë ofrues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të ndërgjegjësuar dhe të gatshëm për të ofruar shërbime miqësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+.

**Treguesit:**

I.1.a. Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara me standarde të përmirësuara e të përshtatura për trajtimin në mënyrën e duhur të personave LGBTI+.

I.1.b. Përqindja e buxhetit të shtetit alokuar për funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara të dedikuara për personat LGBTI+, ose që ofrojnë shërbime miqësore ndaj tyre.

**Masat:**

I.1.1. Ndërtimi/fuqizimi i kapaciteteve të nëpunëseve dhe nëpunësve civilë për të respektuar të drejtat njerëzore të personave LGBTI+.

I.1.2. Përmirësimi i fokusit të shërbimeve mbështetëse të specializuara dhe kthimi i tyre në shërbime plotësisht miqësore edhe për personat LGBTI+.

I.1.3. Mbulimi i nevojave për strehim afatgjatë dhe të përshtatshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për personat LGBTI+.

I.1.4. Mbulim i nevojave për këshillim psiko-emocional dhe këshillim familjar për personat LGBTI+ dhe familjet e tyre.

Nën **objektivin specifik I.2. "Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim"** janë parashikuar:

**Rezultati i arritshëm:**

i. Institucione arsimore më miqësore dhe gjithëpërfshirëse kundrejt personave LGBTI+.

ii. Profesioniste dhe profesionistë të fushës së arsimit më të përgatitur profesionalisht dhe më të gatshëm për të kontribuar në zvogëlimin e pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim.

**Treguesi:**

I.2.a. Numri i fëmijëve, adoleshentëve dhe studentëve LGBTI+ të diskriminuar apo dhunuar, të cilët raportojnë për situatën e tyre në institucionet arsimore dhe mbështeten e trajtohen me prioritet e sipas standardeve nga profesionistet dhe profesionistët e fushës së arsimit.

**Masat:**

I.2.1. Ndërtimi/fuqizimi i kapaciteteve të profesionisteve dhe profesionistëve në sistemin arsimor parauniversitar për të luftuar pabarazitë dhe diskriminimin e personave LGBTI+ në arsim.

I.2.2. Përgatitja e një brezi të ri profesionistesh e profesionistësh me njohuritë e duhura mbi çështjet LGBTI+ dhe repektimin e të drejtave njerëzore të personave LGBTI+.

Nën **objektivin specifik 1.3 "Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin",** janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

i. Shërbime të kujdesit shëndetësor miqësore, të aksesueshme dhe të diponueshme për personat LGBTI+ në mbarë vendin.

ii. Më shumë informacion dhe mjete të unifikuara (protokolle) për trajtimin sipas standardeve të personave transgjinorë dhe interseks.

**Treguesit:**

I.3.a. Numri i punonjëseve dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor parësor të trajnuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore miqësore, cilësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+.

I.3.b. Numri i mjeteve të unifikuara (protokolle) për trajtimin sipas standardeve të personave transgjinorë dhe interseks.

**Masat:**

I.3.1. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionisteve dhe profesionistëve të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, për trajtimin në mënyrën e duhur dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore për personat LGBTI+.

I.3.2: Ofrimi i shërbimeve miqësore, efektive dhe sipas standardeve për personat LGBTI+, sidomos për ata që pësojnë diskriminim të shumëfishtë brenda këtij grupi.

Nën **objektivin specifik I.4 "Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë personat LGBTI+ larg tregut të punës si dhe rritja e aksesit të tyre për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë)."** janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

i. Shërbimet e punësimit dhe formimit profesional më miqësore dhe gjithëpërfshirëse edhe për personat LGBTI+.

ii. Më shumë persona LGBTI+ të përfshirë në tregun e punës dhe të stimuluar për zhvillimin e ideve inovative të lidhur me ekonominë mjedisore dhe dixhitalizimin.

**Treguesit:**

I.4.a. Numri i punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve në fushën e punësimit të trajnuar dhe përgatitur për ofrimin e shërbimeve të punësimit në mënyrë jo-diskriminuese për personat LGBTI+.

I.4.b. Numri i personave LGBTI+ të subvencionuar për zhvillimin e ideve inovatore me fokus tek dixhitalizimi dhe ekonomia mjedisore.

**Masa:**

I.4.1. Nxitja e personave LGBTI+ të besojnë dhe aplikojnë për shërbimet e ofruara në fushën e punësimit dhe zhvillimit të sipërmarrjeve.

**<u>Politika II</u>**

**Qëllimi i Politikës II - Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë.**

Bazuar në gjetjet nga vlerësimi i PKV 2016-2020 në lidhje me përmbushjen e qëllimit të politikës 1 të saj "Korniza ligjore dhe institucionale", në këtë PKV është vënë theksi kryesisht në përafrimin e legjislacionit në lidhje me personat LGBTI+ me standardet evropiane, si dhe në mundësinë për rritjen e aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë përmes fuqizimit të kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve të drejtësisë dhe policimit për trajtimin e rasteve të personave LGBTI+ në mënyrën e duhur, me profesinalizëm dhe përgjegjshmëri.

Tregues kryesor i impaktit nën këtë qëllim të politikës është:

- Numri i rasteve të personave LGBTI+ të diskriminuar/abuzuar, të denoncuara dhe trajtuara në përputhje me legjislacionin e përmirësuar në fuqi.

Për arritjen e këtij qëllimi të politikës II, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë, në partneritet me institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile, do të fokusohen në këto objektiva specifikë:

| | |
|---|---|
| Objektivi specifik II.1: | Përforcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTI+ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës, nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjilslacionit kombëtar me standardet evropiane/ndërkombëtare. |
| Objektivi specifik II.2: | Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+. |

Përmbushja e këtyre objektivave specifikë do të rezultojë në përafrimin e legjislacionit në lidhje me sigurinë e personave LGBTI+, përafrimin e legjislacionit në lidhje me të drejtat e njeriut LGBTI+, duke përfshirë edhe të drejtat e familjes, të drejtën private ndërkombëtare, etj., me standardet evropiane, përafrimin e legjislacionit në lidhje me fuqizimin ekonomik të personave LGBTI+ me standardet evropiane, përafrimin e dispozitave të tjera ligjore në lidhje me LGBTI+ me standardet evropiane, zbatimin efektiv të legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+, etj. Përmbushja e këtyre objektivave specifikë do të lidhet ngushtë dhe me Objektivin Specifik 3.1. të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë (SND 2021-2025) që synon rishikimin e legjislacionit dhe më në detaje ndryshimet në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale.

Kështu më konkretisht, nën **objektivin specifik II.1**. "**Përforcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTI+ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës, nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjilslacionit kombëtar me standardet evropiane/ndërkombëtare"** janë parashikuar:

**Rezultati i arritshëm:**

i. Legjislacion i përmirësuar, veçanërisht për të siguruar ndalimin e gjuhës dhe krimit të urrejtjes, si dhe dhunës ndaj personave LGBTI+.

**Treguesi:**

II.1.a. Numri i propozimeve të dërguara dhe miratuara në lidhje me ndryshimet në legjislacionin civil dhe penal në RSH.

**Masat:**

II.1.1. Përmirësimi i legjislacionit penal për mbrojtje të personave LGBTI+ nga krimi i urrejtjes, gjuha e urrejtjes dhe dhuna (rishikimi i Kodit Penal).

II.1.2. Përmirësimi i legjislacionit familjar (Kodi i Familjes) duke konsideruar edhe të drejtën ndërkombëtare private për të rregulluar njohjen e lidhjeve familjare në situata ndërkufitare.

II.1.3. Përgatitja e disa ligjeve të reja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBTI+, si Ligji për Njohjen e Identitetit Gjinor, aktet nënligjore për mbrojtjen e personave interseks në Shqipëri, si dhe rishikimi i disa ligjeve ekzistuese.

II.1.4. Përmirësimi i legjilsacionit në fushën e punësimit dhe përfshirja në të qartësisht e personave LGBTI+ si një grup që i përfiton të gjitha shërbimet e ofruara në fushën e punësimit dhe formimit profesional.

II.1.5. Analiza, përgatitja dhe miratimi i ndryshimeve të tjera ligjore në përputhje dhe me standardet (Ligjit për Azilin, Ligjit për Gjendjen Civile), etj.

Nën **objektivin specifik II.2** "**Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+."** janë parashikuar:

**Rezultatet e arritshme:**

i. Profesioniste e profesionistë të drejtësisë dhe policimit më të përgatitur dhe të gatshëm për të mbrojtur të drejtat njerëzore të LGBTI+ .

ii. Rritje e besimit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë dhe të policimit.

**Treguesit:**

II.2.a. Numri i raporteve vjetore të përpiluara dhe dorëzuara në Këshillin e Evropës, mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI+.

II.2.b. Numri i personave të caktuar si pika fokale për LGBTI+ në PSHSH në nivel bashkie, të trajnuar.

**Masat:**

II.2.1. Përgatitja e raportit mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI+, në përputhje me standardet ndërkombëtare sipas KE..

II.2.2 Krijimi i një mjedisi lehtësues për denoncimin e krimeve të urrejtjes dhe diskriminimit kundër personave LGBTI+ në ambjentet e PSHSH.

II.2.3. Trajnimi i profesionisteve dhe profesionistëve të Zyrave për Ndihmë Juridike Falas, si dhe i OJF-ve dhe Klinikave të Ligjit të licensuara për ofrimin e ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e shërbimeve të ndjeshme ndaj personave LGBTI+.

II.2.4. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të "PKV LGBTI+ 2021 – 2027".

**Politika III.**

**Qëllimi i Politikës III - Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri.**

Edhe për përmbushjen e këtij qëllimi të politikës janë parashikuar objektiva specifikë të bazuar dhe në PKV 2016-2020 duke shtuar dhe theksuar domosdoshmërinë e ndërgjegjësimit të shoqërisë mbi të drejtat e personave LGBTI+, duke përfshirë qytetarët, OJF-të, sektorin privat dhe grupet profesionale, etj.

Treguesi i impaktit në këtë qëllim të politikës është:

- Numri i personave LGBTI+ të cilët ndiehen të pranuar dhe jo të diskriminuar në shoqëri (përfshirë dhe në fushat e shëndetësisë, arsimit, punësimit, shërbimeve, etj).

Nën këtë qëllim të politikës III janë parashikuar këta objektiva specifikë:

| | |
|---|---|
| Objektivi specifik III.1: | Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit kundrejt personave LGBTI+ |
| Objektivi specifik III.2: | Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI+ midis punëdhënësve privatë. |

Më konkretisht, nën **objektivin specifik III.1. "Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit kundrejt personave LGBTI+",** janë parashikuar:

**Rezultati i pritshëm:**
i. Një brez i ri më i hapur, jo paragjykues dhe pranues kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri.

**Treguesi:**
III.1.a. Numri i të rejave e të rinjve që pranojnë dhe nuk diskriminojnë personat LGBTI+ në Shqipëri.

**Masa:**
III.1.1. Informimi dhe edukimi i vazhdueshëm i shoqërisë me parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe pranimit të personave LGBTI+ në Shqipëri.

Nën objektivin **specifik III.2 "Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI+ midis punëdhënësve publikë e privatë."** janë parashikuar:

**Rezultati i pritshëm:**
i. Një mjedis punëdhënësish më miqësor dhe i hapur ndaj pranimit dhe punësimit të personave LGBTI+.

**Treguesi:**
III.2.a. Numri i ndërmarrjeve / kompanive / bizneseve që bashkohen me Kartën Kombëtare të Diversitetit.

**Masa:**
III.2.1. Krijimi i një mjedisi punëdhënësish miqësor dhe pranues kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri.

# Pjesa III
# Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

**Përgjegjësia e Institucioneve**
Për zbatimin e masave të parashikuara në "PKV LGBTI+ 2021-2027", do të angazhohen një tërësi institucionesh, duke filluar nga ministria pergjegjëse për koordinimin e masave dhe veprimeve për adresimin në mënyrën e duhur të çështjeve LGBTI+, ministritë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre në nivelin vendor, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, akademia, organizatat e shoqërisë civile të fokusuara në mbrojtjen e të drejtave njerëzore, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat dhe zbatimin e tyre në praktikë, ofrimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për grupet e cenueshme dhe në mënyrë të veçantë vetë organizatat LGBTI+, si dhe organizatat ndërkombëtare.

Siç edhe përcaktohet qartësisht në Matricën e Logjikës së Ndërhyrjes (Aneksi 4 i PKV), institucionet kanë përgjegjësi direkte për zbatimin e masave dhe veprimeve të caktuara, por gjithashtu janë edhe në pozicionin mbështetës apo bashkëpunues të institucionit kryesor përgjegjës. Për vetë pozicionin koordinues, si dhe për rolin kryesor në përgatitjen e këtij PKV, MSHMS është përcaktuar edhe si institucioni kryesor përgjegjës përsa i takon raportimit për progresin në zbatimin e PKV. Kuptohet që sikurse në zbatim, edhe në përgatitjen e raportimit mbi ecurinë e veprimeve të ndërmarra ka shumë rëndësi mbështetja dhe bashkëpunimi i të gjithë partnerëve dhe bashkëpunëtorëve.

## Llogaridhënia, Monitorimi dhe Raportimi

**Llogaridhënia**
Kuadri monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin Tematik Ndërinstitucional të Përfshirjes dhe Mbrojtjes Sociale ngritur me Urdhërin nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar". Përqasja dhe rishikimi i këtij dokumenti strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM nr. 290, datë 11.04.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS".

Ndërsa për përcaktimin e bazës së treguesve për masat e reja të propozuara, sugjerohet që të ndërmerren veprimet e vlerësimit të situatës dhe përcaktimit të kësaj baze përmes sondazheve e studimeve dhe vendosja një sistemi të mirë organizuar në mbledhjen e të dhënave të ndara sipas grupimeve përkatëse, ku të mos

mungojë edhe ndarja sipas orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, për të gjitha aktivitetet që do të zbatohen në kuadër të këtij PKV.

**Monitorimi**

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij PKV do të paraqitet në mënyrë periodike tek Grupi Tematik Ndërinstitucional i Përfshirjes dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu kopje të raporteve të monitorimit do t'i vihen në dispozicion edhe GKZK. Për të lehtësuar procesin e mbledhjes së të dhënave në kuadër të monitorimit periodik të zbatimit të PKV, MSHMS do të përgatisë mjetet e nevojshme për mbledhjen e informacioinit, në përputhje dhe me formatet e miratuara dhe të kërkuara për plotësim gjatë raportimit në përputhje me sistemin IPSIS. Gjithashtu do të orientojë paraprakisht të gjitha institucionet qendrore, vendore si dhe institucionet e pavarura, mbi përgjegjësitë që kanë për hedhjen e hapave të përvitshëm në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara, në pozicionin e institucionit kryesor përgjegjës.

Gjatë punës së përditshme, përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të PKV qëndron tek të gjitha institucionet e përcaktuara si institucione kryesore përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara, ndërsa tek Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, nëpunëset/nëpunësit e barazisë gjinore do të jenë përgjegjës për dhënien e informacionit mbi aktivitetet e zhvilluara me në fokus çështjet LGBTI+. Menaxhimi i rasteve të personave LGBTI+ të dhunuar në familje, do të kryhet përmes qasjes shumësektoriale të koordinuar, përmes punës së Koordinatoreve/Koordinatorëve Vendorë (KV) dhe antarëve të Ekipit Teknik Ndërdisiplinar të MKR-ve të ngritura në të 61 bashkitë në vend, si dhe duke angazhuar edhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), nëse bëhet fjalë për fëmijë LGBTI+ të dhunuar në familje. Kjo nënkupton që edhe raportimi për raste të tilla të menaxhuara do të kryhet përmes KV dhe NJMF.

MSHMS ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit vjetor të PKV. Organizatat e shoqërisë civile luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve, në zbatimin dhe mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave, ofrimit të shërbimeve dhe zbatimit të legjislacionit e politikave në tërësi, për avancimin drejt respektimit të të drejtave kushtetuese dhe të njeriut të personave LGBTI+.

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në PKV, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument, konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tij me qëllim përmbushjen e objektivave në mënyrë sa më efektive.

Më konkretisht do të ndërmerren këto masa:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në PKV;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet si dhe eksperiencat e mëparshme, në përputhje edhe me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian, ECRI dhe dokumentave të tjerë ndërkombëtarë;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të kryhet monitorim dhe do të hartohen raporte vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të PKV.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura me avancimin drejt respektimit të të drejtave kushtetuese dhe të njeriut të personave LGBTI+.

**Vlerësimi**
Për shkak të kohëzgjatjes shtatëvjeçare të zbatimit të "PKV LGBTI+ 2021 – 2027", si dhe për të siguruar një përputhje me të mirë edhe me OZHQ, është menduar që përveç monitorimeve vjetore të zbatimit të këtij PKV, të ketë edhe një proces vlerësimi të pëgjithshëm në fundin e vitit të katërt të zbatimit të tij. Bazuar mbi këtë vlerësim mund të ndyshohen/hiqen (nëse janë realizuar plotësisht) dhe shtohen jo vetëm veprime e masa, por edhe objektiva specifikë nën qëllimet e politikave bazë.

**Raportimi**
Të gjithë institucionet e ngarkuara me zbatimin e "PKV LGBTI+ 2021-2027" do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe një vjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këtë PKV, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.
MSHMS do të jetë institucioni udhëheqës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet përkatëse duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6 mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatin Teknik Ndërinstitucional.

# Pjesa IV
# **Analiza buxhetore**

## 4.1. ANALIZA E BUXHETIT PËR ZBATIMIN E "PKV LGBTI+ 2021-2027"

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen e kostove indikative dhe burimeve financiare që financojnë masat e "PKV LGBTI+ 2021-2027". Efektet financiare janë përllogaritur për çdo masë bazuar në aktivitetet që janë të parashikuar në PKV dhe mbështetur në analizën e bërë për nevojat për burime për secilin aktivitet. Efektet financiare parashikohet të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave si institucione kryesore përgjegjëse, nga buxhete të institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e një pjesë të masave si institucione mbështetëse, si dhe nga burime të tjera, përfshirë dhe donatorët.

Procesi i kostimit është mbështetur në konsultimin e dokumentave kombëtarë, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, si dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, duke mbajtur në konsideratë edhe kostot historike nga zbatimi i PKV së mëparshëm. PKV shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili është mbështetur nga detajimi i hollësishëm i çdo aktiviteti.

Kostimi është bazuar në tableat e përkaëtse të formutuara të cilat japin të dhëna finaciare në lidhje me masat, shoqëruar me kodet e programeve buxhetore sipas çdo institucioni përkatës në formë të detajuar sipas standarteve të kërkuara nga IPSIS.
Objektivat përkatëse janë shtjelluar bazuar në masa dhe në aktivitet të detajuara, mbi bazën e të cilave është kryer kostimi duke respektuar tavanet përkatëse të PBA 2021-2023.

Çdo aktvitet është detajuar dukë përshkruar (formati IV) në mënyrë të detajuar rezultatin e arritshëm si një tregues përformace i cili do të shërbejë në të ardhmen si tregues për të monitoruar dhe vlerësuar masat dhe objetivat përkatëse të Planit Kombëtar të Veprimit.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e "PKV LGBTI+ 2021 – 2027" është **351 909 255 Lekë**, ose - 2 837 978 **Euro**. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 124 lek për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 7 viteve të zbatimit të "PKV LGBTI+ 2021 – 2027".

**Nevojat (në Lek)**

| Qëllimi i Politikave | Natyra/ Tipologjia e Kostove | Kostoja Totale 2021-2027 | Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023/ Burime të tjera dhe Donatoret | Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024-2027 | Hendeku Financiar 2021-2030 |
|---|---|---|---|---|---|
| PI: Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specfike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane/ndërkombëtare. | Korente | 252,535,577 | 93,440,616 | 117,959,386 | **41,135,575** |
| | Kapitale | 14,145,000 | 3,105,000 | 11,040,000 | |
| P II: Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë. | Korente | 43,367,309 | 9,246,192 | 18,920,512 | **15,200,606** |
| | Kapitale | 34,500 | 0 | 34,500 | |
| P III: Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri. | Korente | 41,826,869 | 9,981,240 | 16,081,017 | **15,764,612** |
| | Kapitale | 0 | 0 | 0 | |
| **TOTALI [Leke]** | | **351,909,255** | **115,773,048** | **164,035,415** | **72,100,792** |
| **TOTALI [Euro] 1 euro 124 Lekë** | | **2,837,978** | **933,654** | **1,322,866** | **581,458** |

Financimi i PKV do të realizohet nga disa burime, si buxheti i shtetit, fondet e NJVV dhe mbështetja financiare nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm.

Për periudhën 2021-2027, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 62.3% të financimit të nevojshëm, 18.3% pritet të financohet nga burime të tjera dhe donatorët, ndërsa 20.5% është hendek financiar.




Kostot korente zënë rreth 96% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (4%) është e parashikuar për kosto kapitale.




Tabela e mëposhtme jep të dhënat sipas 3 qëllime kryesore, pjesa më e madhe e investimeve shkon për mbështetjen e këtij grupi vulnerabël për subvencionim të sipërmarrjeve të personave LGBTI+ që zbatojnë ide inovatore me fokus tek dixhitalizimi dhe ekonomia mjedisore.

Plani i Kombëtar i Veprimit është parashikuar për të patur një rishikim afatmesëm gjatë vitit 2024-2025, nëpërmjet të cilit do të vlerësohen masat e arritura duke reflektuar ndryshme objektive për të ardhmen, në rezultat, dhe në rishikimin e treguesve të performancës.




Buxhetimi i PKV është një kosto e pritshme e aktiviteteve të cilat do të realizohen në kuadër të masave të marra për çdo objektiv dhe si i tillë ka edhe risqet e tij, të cilat janë si më poshtë:

- Risqet në burimet njerëzore të nevojshme për të realizuar aktivitet, si dhe ndryshimi i pagave (e cila do të japi një efekt në rritje) si dhe llogaritja e përafërt e kohës së punës për çdo aktivitet, janë risqe të cilat mund të kenë impakte në tejkalim të kostove të aktivitetit, përtej tavaneve përkatëse.
- Kordinimi ndërinstitucional për të realizuar masat e PKV bazuar në prioritet vjetore të paparashikuara që mund të ndodhin.
- Koordinimi i mirë me donatorët dhe bashëkrendimi me planet e tyre vjetore për të realizuar aktivitet përkatëse, brenda afateve kohore duke mos krijuar vonesa në realizimin e masave të cilat mund të kenë impakt në buxhetin pasaardhës.
- Sigurimi i finacimit të plotë të aktiviteteve përtej PBA 2021-2023, pas kryerjes së vlerësimit të PKV.
- Ndryshimi i fondeve të investimeve si pasojë e ndryshimit të prioritetve të MSHMS

# ANEKS 1. MATRICA E QËLLIMEVE TË POLITIKËS DHE TREGUESIT

| Lloji i treguesit | Emërtimi i Indikatorit | Lidhja me Nr e Shtyllës së SKZHI | Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI | Qëllimi i Politikës | Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi | Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| impakti | Numri i personave LGBTI+ të cilët përfitojnë shërbime mbështetëse të specializuara miqësore e sipas standardeve | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.6. Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore | Aksesueshmëria në shërbime mbështetëse të specializuara sipas standardeve | Qëllimi i Politikës I - Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specfike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane /ndërkombëtare | MSHMS |
| impakti | Numri i personave transgjinorë dhe interseks të trajtuar në aspektin shëndetësor sipas protokolleve shëndetësore, të miratuara në përputhje me standardet evropiane / ndërkombëtare. | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.2. Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm | Kujdes shëndetësor universal cilësor dhe në kohë | Qëllimi i Politikës I - Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specfike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane /ndërkombëtare | MSHMS |
| impakti | Numri i rasteve të personave LGBTI+ të diskriminuar / abuzuar, të denoncuara dhe trajtuara në përputhje me legjislacionin e përmirësuar në fuqi. | 8.QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIAS UNDIMI I LIGJIT | 8.5 Forcimi i rendit publik | Shërbime për rastet e diskriminuara dhe dhunuara të ofruara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar | Qëllimi i Politikës II. Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë | MB/PSHSH & MD/Gjykatat |
| impakti | Numri i personave LGBTI+ të cilët ndiehen të pranuar dhe jo të diskriminuar në shoqëri (përfshirë dhe në fushat e shëndetësisë, arsimit, punësimit, shërbimeve, etj) | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Ndërgjegjësimi i publikut dhe krijimi i një mjedisi pranues për LGBTI+ | Qëllimi i Politikës III: Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri | MSHMS |

## ANEKS 2. MATRICA E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE DHE TREGUESIT

| Lloji i treguesit | Emërtimi i Indikatorit | Lidhja me Nr e Shtyllës së SKZHI | Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI | Qëllimi i Politikës | Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi | Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| rezultati | I.1.a. Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara me standarde të përmirësuara e të përshtatura për trajtimin në mënyrën e duhur të personave LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.6. Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore | Aksesueshmëria në shërbime mbështetëse të specializuara sipas standardeve | Objektivi specifik I.1. Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+ | MSHMS |
| rezultati | I.1.b. Përqindja e buxhetit të shtetit alokuar për funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara të dedikuara për personat LGBTI+, ose që ofrojnë shërbime miqësore ndaj tyre. | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.6. Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore | Aksesueshmëria në shërbime mbështetëse të specializuara sipas standardeve | Objektivi specifik I.1. Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+ | MSHMS |
| rezultati | I.2.a. Numri i fëmijëve, adoleshentëve dhe studentëve LGBTI+ të diskriminuar apo dhunuar, të cilët raportojnë për situatën e tyre në institucionet arsimore dhe mbështeten e trajtohen me prioritet e sipas standardeve nga profesionistet dhe profesionistët e fushës së arsimit. | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.1. Më shumë mundësi dhe më shumë cilësi në arsim | Sisteme arsimore jo diskriminuese që mbrojnë të drejtat e njeriut | Objektivi specifik I.2: Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim | ASCAP |
| rezultati | I.3.a. Numri i punonjëseve dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor parësor të trajnuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore miqësore, cilësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.2. Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm | Kujdes shëndetësor universal cilësor dhe në kohë | Objektivi specifik I.3. Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin. | MSHMS |
| rezultati | I.3.b. Numri i mjeteve të unifikuara (protokolle) për trajtimin sipas standardeve të personave transgjinorë dhe interseks | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.2. Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm | Kujdes shëndetësor universal cilësor dhe në kohë | Objektivi specifik I.3. Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin. | MSHMS |

| Lloji i treguesit | Emërtimi i Indikatorit | Lidhja me Nr e Shtyllës së SKZHI | Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI | Qëllimi i Politikës | Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi | Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| rezultati | I.4.a. Numri i punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve në fushën e punësimit të trajnuar dhe përgatitur për ofrimin e shërbimeve të punësimit në mënyrë jo-diskriminuese për personat LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.3. Shtimi i mundësive të punësimit | Shërbime punësimi miqësore e profesionale | Objektivi specifik I.4. Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë personat LGBTI+ larg tregut të punës si dhe rritja e aksesit të tyre për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë). | MFE |
| rezultati | I.4.b. Numri i personave LGBTI+ të subvencionuar për zhvillimin e ideve inovatore me fokus tek dixhitalizimi dhe ekonomia mjedisore | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.3. Shtimi i mundësive të punësimit | Shërbime punësimi miqësore e profesionale | Objektivi specifik I.4. Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë personat LGBTI+ larg tregut të punës si dhe rritja e aksesit të tyre për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë). | MFE & AIDA&Bashkia |
| rezultati | II.1.a. Numri i propozimeve të dërguara dhe miratuara në lidhje me ndryshimet në legjislacionin civil dhe penal në RSH | 8.QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA SUNDIMI I LIGJIT | 8.6. Forcimi i të drejtave të njeriut | Përafrimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor | Objektivi specifik II.1. Përforcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTI+ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës, nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjilslacionit kombëtar me standardet evropiane/ndërkombëtare | Të gjitha ministritë që kanë përgjegjësi zbatimin e ligjeve të ndryshuara dhe MD |
| rezultati | II.2.a. Numri i raporteve vjetore të përpiluara dhe dorëzuara në Këshillin e Evropës, mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI+ | 8.QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA SUNDIMI I LIGJIT | 8.6. Forcimi i të drejtave të njeriut | Fuqizimi i mekanizmave monitorues për të drejtat e njeriut | Objektivi specifik II.2. Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+. | KMD |

| Lloji i treguesit | Emërtimi i Indikatorit | Lidhja me Nr e Shtyllës së SKZHI | Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI | Qëllimi i Politikës | Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi | Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| rezultati | III.1.a. Numri i të rejave e të rinjve që pranojnë dhe nuk diskriminojnë personat LGBTI+ në Shqipëri | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Ndërgjegjësimi i publikut dhe krijimi i një mjedisi pranues për LGBTI+ | Objektivi specifik III:.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit kundrejt personave LGBTI+ | MSHMS |
| rezultati | III.2.a.Numri i ndërmarrjeve / kompanive / bizneseve që bashkohen me Kartën Kombëtare të Diversitetit. | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Punëdhënës më të ndjeshëm dhe jo-diskriminues | Objektivi specifik III.2.Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI+ midis punëdhënësve publikë e privatë. | MFE |

# ANEKS 3. MATRICA E MASAVE DHE TREGUESIT

| Lloji i treguesit | Emërtimi i Indikatorit | Lidhja me Nr e Shtyllës se SKZHI | Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI | Qëllimi i Politikës | Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi | Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| masa | Numri i nëpunëseve dhe nëpunësve civilë qendrorë e vendorë të trajnuar për të trajtuar me ndjeshmërinë e duhur dhe sipas standardeve çështjet LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Ndërtimi i kapaciteteve të profesionistëve | Objektivi specifik I.1. Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+ | ASPA |
| masa | Numri i raporteve të monitorimit të përgatiutura nga KMD për numrin e ankesave të shqyrtuara kryesisht prej këti institucioni për rastet e personave LGBTI+ të diskriminuar | 8. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS | 8.6. Forcimi i të drejtave të njeriut | Fuqizimi i mekanizmave monitorues për të drejtat e njeriut | Objektivi specifik I.1. Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+ | KMD dhe MSHMS |
| masa | Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të sistemit arsimor parauniversitar të trajnuar për çështjet LGBTI+ dhe identifikimin e referimin e rasteve të diskriminimit ndaj tyre | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.1. Më shumë mundësi dhe më shumë cilësi në arsim | Profesioniste e profesionistë të kualifikuar | Objektivi specifik I.2. Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim | ASCAP |
| masa | Numri i kurrikulave të përmirësuara në sistemin e arsimit të lartë/studime të formimit të vazhduar me modulin mbi çështjet LGBTI+ të shtuar | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.1. Më shumë mundësi dhe më shumë cilësi në arsim | Sisteme arsimore jo diskriminuese që mbrojnë të drejtat e njeriut | Objektivi specifik I.2. Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim | IAL |
| masa | Numri i  i mjekeve dhe mjekëve obstetër-gjinekologë, andrologë, neonatë si  dhe mamive dhe mjekëve të familjes të trajnuar mbi zbatimin e dy protokolleve të miratuara | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.2. Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm | Kujes shëndetësor universal cilësor dhe në kohë | Objektivi specifik I.3. Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin. | MSHMS |
| masa | Numri i testeve për SST dhe HIV për personat LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.2. Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm | Kujdes shëndetësor universal cilësor dhe në kohë | Objektivi specifik I.3. Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin. | MSHMS |

| Lloji i treguesit | Emërtimi i Indikatorit | Lidhja me Nr e Shtyllës se SKZHI | Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI | Qëllimi i Politikës | Objektivi Specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi | Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| masa | II.2.b. Numri i personave të caktuar si pika fokale për LGBTI+ në PSHSH në nivel bashkie, të trajnuar | 8.QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA SUNDIMI I LIGJIT | 8.5 Forcimi i rendit publik | Shërbime për rastet e diskriminuara dhe dhunuara të ofruara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar | Objektivi specifik II.2. Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+. | MB/PSHSH |
| masa | Numri i profesionisteve dhe profesionistëve në fushën e ofrimit të ndihmës ligjore, të trajnuar për shërbime të ndjeshme ndaj pesonave LGBTI+ | 8. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA SUNDIMI I LIGJIT | 8.5 Forcimi i rendit publik | Shërbime për rastet e diskriminuara dhe dhunuara të ofruara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar | Objektivi specifik II.2. Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+. | MD/DNJF |
| masa | Numri i raporteve vjetore të monitorimit të zbatimit të PKV LGBTI+ 2021 - 2027 | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Institucione të përgjegjshme dhe transparente | Objektivi specifik II.2. Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+. | MSHMS |
| masa | Numri i fushatave ndërgjegjësuese të realizuara mbi çështjet LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Ndërgjegjësimi i publikut dhe krijimi i një mjedisi pranues për LGBTI+ | Objektivi specifik III.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit kundrejt personave LGBTI+ | MSHMS |
| masa | Numri i institucioneve shtetërore qendrore e vendore që miratojnë politika të ndjeshme dhe jo diskriminuese për personat LGBTI+ | 3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL | 11.7 Ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse | Punëdhënës më të ndjeshëm dhe jo-diskriminues | Objektivi specifik III.2. Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI+ midis punëdhënësve publikë e privatë. | Ministritë e linjës dhe NJVV |

## ANEKS 4. LOGJIKA E NDËRHYRJES, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE, AFATET KOHORE

| LOGJIKA E NDËRHYRJES | | | |
|---|---|---|---|
| Qëllimi i Politikës I: | **Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specfike të tyre dhe me standardet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane/ndërkombëtare.** | | |
| Objektivi specifik I.1: | **Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror cilësore dhe miqësore ndaj personave LGBTI+** | | |
| **Rezultatet e pritshme:** | i. Shërbime mbështetëse të specializuara të aksesueshme dhe disponueshme edhe nga personat LGBTI+ në mbarë vendi.<br>ii. Profesioniste dhe profesionistë ofrues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të ndërgjegjësuar dhe të gatshëm për të ofruar shërbime miqësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+. | | |
| **Treguesit:** | | Baseline: | Target |
| | I.1.a. Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara me standarde të përmirësuara e të përshtatura për trajtimin në mënyrën e duhur të personave LGBTI+ | 1 shërbim me standarde të përshtatura për personat LGBTI+ ("Streha", 2020) | 3 tipe standardesh kombëtare për 3 lloj shërbimesh mbështetëse të specializuara të rishikuara |
| | I.1.b. Përqindja e buxhetit të shtetit alokuar për funksionimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara të dedikuara për personat LGBTI+, ose që ofrojnë shërbime miqësore ndaj tyre. | Buxheti që ofrohet nga shteti për mbështetjen e "Strehës"(2021) | Rritur me 1% çdo vit |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **I.1.1. Ndërtimi/fuqizimi i kapaciteteve të nëpunëseve dhe nëpunësve civilë për të respektuar të drejtat njerëzore të personave LGBTI+** | | **ASPA** | **MSHMS, ministritë e linjës, NJVV, AP, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare** | **6-M-II 2021 – 6-M-II 2027** |
| I.1.1.a. Përgatitja e një moduli për çështjet dhe të drejtat e personave LGBTI+ si pjesë e ciklit trajnues për nëpunëset dhe nëpunësit civilë. | Moduli i përgatitur | **ASPA** | MSHMS, AP, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2021 – 6-M-I 2022 |
| I.1.1.b. Trajnimi i përvitshëm për nëpunëset dhe nëpunësit civilë mbi respektimin e të drejtave të personave LGBTI+. | Nëpunëse dhe nëpunës civilë qendrorë e vendor të trajnuar | **ASPA** | MSHMS, ministritë e linjës, NJVV, AP, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.1.1.c. Trajnimi i NBGJ qendrorë mbi çështjet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të personave LGBTI+ në Shqipëri si dhe mbi përmbajtjen e PKV për LGBTI+ 2021 - 2030 | NBGJ qendrorë të trajnuar | **MSHMS** | Ministritë e linjës, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2021 – 6-M-II 2021 |
| I.1.1.d. Trajnimi i NBGJ vendorë dhe KV kundër dhunës në familje në të 61 bashkitë mbi çështjet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të personave LGBTI+ në Shqipëri si dhe mbi përmbajtjen e PKV për LGBTI+ 2021 - 2030 | NBGJ dhe KV vendorë të trajnuar | **MSHMS** | NJVV, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2021 – 6-M-I 2022 |
| **I.1.2. Përmirësimi i fokusit të shërbimeve mbështetëse të specializuara dhe kthimi i tyre në shërbime plotësisht miqësore edhe për personat LGBTI+** | | **MSHMS** | **NJVV, AP, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare** | **6-M-I 2022 – 6-M-II 2027** |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| I.1.2.a. Rishikimi i standarteve të shërbimeve të kujdesit shoqëror për shërbimet mbështetëse të specializuara dhe përfshirja në to e parimeve dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve miqësore edhe për personat LGBTI+. | Standardet e rishikuara për 3 lloj shërbimesh të tilla | **SHSSH** | NJVV, AP, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2022 – 6-M-II 2022 |
| I.1.2.b. Trajnimi i punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të ofruar shërbimet e duhura për personat LGBTI+, në përputhje me standardet e rishikuara | Punonjëse dhe punonjës të trajnuar | **SHSSH** | NJVV, AP, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2023 – 6-M-II 2024 |
| I.1.2.c. Trajnimi i anëtareve të Ekipeve Teknike Ndërdisiplinare të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje në nivel bashkie, si dhe i punonjëseve dhe punonjësve të NJMF-ve, për të trajtuar në mënyrën e duhur rastet e personave LGBTI+ viktima/të mbijetuar të kësaj forme dhune. | 61 MKR në nivel bashkie (nga 10 MKR në vit) më të gatshëm për të trajtuar në mënyrë profesionale rastet e personave LGBTI+ të dhunuar në familje | **NJVV** | MB/AMVV, MSHMS, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.1.2.d. Mbledhja e të dhënave dhe monitorimi i numrit të ankesave, çështjeve të shqyrtuara kryesisht, si dhe vendimeve të dhëna nga KMD lidhur me aksesin e personave LGBTI+ në shërbimet sociale**.** | Raporti i monitorimit i përgatitur me të dhënat përkatëse të disagreguara | **KMD** | NJVV, INSTAT, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare | 6-M-I 2022 – 6-M-I 2027 |
| **I.1.3. Mbulimi i nevojave për strehim afatgjatë dhe të përshtatshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për personat LGBTI+** | | **MSHMS** | **MF, MB/AMVV, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare** | **6-M-II 2021 – 6-M-II 2027** |
| I.1.3.a. Mbështetja financiare e shërbimit të specializuar të strehimit afatgjatë për personat LGBTI+ (Streha) | Qendra "Streha" funksionale sipas standardeve të miratuara | **MSHMS** | MF, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2021 – 6-M-II 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| I.1.3.b. Shtrirja e shërbimit të specializuar të strehimit për personat LGBTI+ edhe në dy qarqe të tjera në vend | Shërbimi i specializuar i strehimit, i zgjeruar dhe më i aksesueshëm nga personat LGBTI+ | **MSHMS** | MF, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2023 – 6-M-II 2027 |
| I.1.3.c. Përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në nevojë për strehim, nëpërmjet mbështetjes me banesa sociale dhe bonus qeraje, në përputhje me kriteret ligjore të përfitimit të këtij shërbimi. | Numri në rritje i personave LGBTI+ që përfitojnë shërbime të strehimit social | **NJVV** | MB/AMVV, MF, MSHMS, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2022 – 6-M-II 2027 |
| **I.1.4. Mbulim i nevojave për këshillim psiko-emocional dhe këshillim familjar per personat LGBTI+ dhe familjet e tyre** | | **MSHMS** | **MB/AMVV, NJVV, MFE, OJF, Org.ndërkombëtare** | **6-M-I 2023 – 6-M-II 2027** |
| I.1.4.a.Fuqizimi i Shërbimit SOS LGBTI+ dhe informimi i shoqërisë mbi ekzistencën e këtij shërbimi | SOS LGBTI+ i mbështetur financiarisht edhe me buxhetin e shtetit | MSHMS | MB/AMVV, NJVV, MFE, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-I 2023 – 6-M-II 2027 |
| I.1.4.b. Pilotimi në 5 qendra komunitare multifunksionale të Bashkisë Tiranë i grupeve të këshillimit për prindërit/familjarët e personave LGBTI+ | 5 programe këshillimi familjar të ngritura në nivel NJVV | NJVV | MSHMS, MB/AMVV, MFE, FSHS, OJF, org. ndërkombëtare | 6-M-I 2023 – 6-M-II 2025 |
| I.1.4.c. Shtrirja e shërbimi të këshillimit të prindërve/familjarëve të LGBTI+ edhe në dy qarqe të tjera | Modeli i Bashkisë Tiranë i replikuar edhe në dy bashki të tjera | NJVV | MSHMS, MB/AMVV, MFE, FSHS, OJF, org. ndërkombëtare | 6-M-I 2026 – 6-M-II 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik I.2:** | **Zvogëlimi i pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim** | | | | |
| **<u>Rezultatet e pritshme:</u>** | i. Institucione arsimore më miqësore dhe gjithëpërfshirëse kundrejt personave LGBTI+<br>ii. Profesioniste dhe profesionistë të fushës së arsimit më të përgatitur profesionalisht dhe më të gatshëm për të kontribuar në zvogëlimin e pabarazive dhe diskriminimit të personave LGBTI+ në arsim | | | | |
| **<u>Treguesit:</u>** | I.2.a. Numri i fëmijëve, adoleshentëve dhe studentëve LGBTI+ të diskriminuar apo dhunuar, të cilët raportojnë për situatën e tyre në institucionet arsimore dhe mbështeten e trajtohen me prioritet e sipas standardeve nga profesionistet dhe profesionistët e fushës së arsimit. | | | <u>Baseline</u>:<br>Do përcaktohet gjatë vitit shkollor 2021 - 2022 | <u>Target</u>:<br>Rritur me 1% çdo vit |
| **I.2.1. Ndërtimi/fuqizimi i kapaciteteve të profesionisteve dhe profesionistëve në sistemin arsimor parauniversitar për të luftuar pabarazitë dhe diskriminimin e personave LGBTI+ në arsim.** | | | **ASCAP** | **MAS, MSHMS, NJVV, OJF, Org.ndërkombëtare** | **6-M-I 2022 – 6-M-II 2027** |
| I.2.1.a. Përgatitja e një moduli për trajnimin e profesionisteve dhe profesionistëve në sistemin arsimor parauniversitar, lidhur me çështjet LGBTI+ | | Moduli i përgatitur dhe akredituar | ASCAP | MAS, MSHMS, KMD, OJF, org. ndërkombëtare | 6-M-I 2022 – 6-M-II 2022 |
| I.2.1.b. Trajnimi i profesionisteve dhe profesionistëve të arsimit parauniversitar mbi çështjet LGBTI+ | | Profesioniste dhe profesionistë të arsimit parauniversitar të trajnuar | ASCAP | MAS, MSHMS, KMD, OJF, org. ndërkombëtare | 6-M-I 2023 – 6-M-II 2027 |
| **I.2.2. Përgatitja e një brezi të ri profesionistesh e profesionistësh me njohuritë e duhura mbi çështjet LGBTI+ dhe repektimin e të drejtave njerëzore të personave LGBTI+** | | | **IAL** | **MAS, NJVV, MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare** | **6-M-II 2022 – 6-M-II 2027** |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| I.2.2.a. Përfshirja në kurrikulat e arsimit të lartë/studimeve të formimit të vazhduar të shkencave sociale, i moduleve mbi çështjet dhe të drejtat e personave LGBTI+ | Kurrikula e përmirësuar | Universiteti i Tiranës, FSHS | MAS, MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.2.2.b. Përfshirja në kurrikulat e arsimit të lartë/studimeve të formimit të vazhduar të shkencave të edukimit i moduleve mbi çështjet dhe të drejtat e personave LGBTI+ | Kurrikula e përmirësuar | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë | MAS, MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.2.2.c. Përfshirja në kurrikulat e arsimit të lartë/studimeve të formimit të vazhduar të drejtësisë i moduleve mbi çështjet dhe të drejtat e personave LGBTI+ | Kurrikula e përmirësuar | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë | MAS, MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.2.2.d. Përfshirja e modulit mbi të drejtat dhe mbrojtjen e personave LGBTI+ në trajnimin fillestar dhe vazhdues me gjyqtarët e prokurorët | Kurrikula e përmirësuar | Shkolla e Magjistraturës | MD, MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.2.2.e. Përfshirja në kurrikulat e arsimit të lartë/studimeve të formimit të vazhduar të policimit i moduleve mbi çështjet dhe të drejtat e personave LGBTI+ | Kurrikula e përmirësuar | Akademia e Sigurisë | MB/PSHSH, MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |
| I.2.2.f. Përfshirja në kurrikulat e arsimit të lartë/studimeve të formimit të vazhduartë mjekësisë i moduleve mbi çështjet dhe të drejtat e personave LGBTI+ | Kurrikula e përmirësuar | Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT) | MSHMS, OJF, Org.ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-II 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik I.3:** **Garantimi i aksesit për personat LGBTI+ në shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjithë vendin.** | | | | |
| **Rezultatet e pritshme:** i. Shërbime të kujdesit shëndetësor miqësore, të aksesueshme dhe të diponueshme për personat LGBTI+ në mbarë vendin<br>ii. Më shumë informacion dhe mjete të unifikuara (protokolle) për trajtimin sipas standardeve të personave transgjinorë dhe interseks | | | | |
| **Treguesit** I.3.a. Numri i punonjëseve dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor parësor të trajnuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore miqësore, cilësore dhe sipas standardeve për personat LGBTI+ | | | Baseline:<br>Do të përcaktohet gjatë vitit 2022 | Target:<br>360 profesioniste dhe profesionistë të kujdesit shëndetësor parësor të trajnuar çdo vit |
| I.3.b. Numri i mjeteve të unifikuara (protokolle) për trajtimin sipas standardeve të personave transgjinorë dhe interseks | | | 1 (2021) | 2 (2023) |
| **I.3.1. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionisteve dhe profesionistëve të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor, për trajtimin në mënyrën e duhur dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore për personat LGBTI+** | | **MSHMS** | **OSHKSH/NJVKSH, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare** | **2022-2027** |
| I.3.1.a. Rishikimi, përditësimi dhe akreditimi i modulit për trajnimin e profesionisteve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor parësor, për çështjet LGBTI+ | Moduli i akredituar | MSHMS | OSHKSH/NJVKSH, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2021 – 6-M-I 2022 |
| I.3.1.b. Trajnimi i profesionisteve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor parësor, për çështjet LGBTI+ | 360 profesioniste dhe profesionistë të shëndetësisë të trajnuar çdo vit | OSHKSH/ NJVKSH | MSHMS, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-I 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **I.3.2.Ofrimi i shërbimeve miqësore, efektive dhe sipas standardeve për personat LGBTI+, sidomos për ata që pësojnë diskriminim të shumëfishtë brenda këtij grupi** | | **MSHMS** | **KMD, AP, OJF-të Org. ndërkombëtare** | 6-M-I 2022 – 6-M-II 2022 |
| I.3.2.a. Hartimi dhe miratimi i një Protokoll Mjekësor Transgjinor | Protokolli i miratuar | MSHMS | OSHKSH/NJVKSH, NJVV, KMD, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2022 – 6-M-II 2022 |
| I.3.2.b. Trajnimi i mjekeve dhe mjekëve obstetër-gjinekologë, andrologë, neonatë si dhe mamive dhe mjekëve të familjes mbi zbatimin e dy protokolleve të miratuara | rreth 1500 profesionistë të trajnuar | OSHKSH /NJVKSH | MSHMS, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-I 2023 – 6-M-II 2027 |
| I.3.2.c. Përditësimi i dokumentacionit adminsitrativ shëndetësor në përputhje me standardet ndërkombëtare: vendosja e kodeve në mënyrë të unfikuar sipas kodifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-X | Dokumentacioni admionistrativ shëndetsor i përditësuar dhe unifikuar | MSHMS | NJVKSH, QSUT, QSUOGJ, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2022 – 6-M-I 2023 |
| I.3.2.d. Grumbullim sistematik i dedikuar të dhënash sipas formularëve të përditësuar | Të dhëna mbi situatën shëndetësore të personave LGBTI+ të përditësuara | MSHMS | NJVKSH, QSUT, QSUOGJ, OJF, Org. ndërkombëtare | 6-M-II 2023 – 6-M-I 2027 |
| I.3.2.e. Kryerja e testimeve për personat LGBTI+ për SST dhe HIV, në mënyrë anonime në mbarë vendin. | Numri i testeve për SST dhe HIV për personat LGBTI+ | MSHMS | Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, OJF-të | 6-M-II 2021 – 6-M-II 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik I.4:** **Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë personat LGBTI+ larg tregut të punës si dhe rritja e aksesit të tyre për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).** | | | | |
| <u>**Rezultatet e pritshme:**</u> i. Shërbimet e punësimit dhe formimit profesional më miqësore dhe gjithëpërfshirëse edhe për personat LGBTI+<br>ii. Më shumë persona LGBTI+ të përfshirë në tregun e punës dhe të stimuluar për zhvillimin e ideve inovative të lidhur me ekonominë mjedisore dhe dixhitalizimin | | | | |
| **Treguesit** I.4.a. Numri i punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve në fushën e punësimit të trajnuar dhe përgatitur për ofrimin e shërbimeve të punësimit në mënyrë jo-diskriminuese për personat LGBTI+ | | | <u>Baseline:</u><br>Do përcaktohet në vitin 2022 | <u>Target:</u><br>180 punonjëse dhe punonjës të trajnuar çdo vit |
| I.4.b. Numri i personave LGBTI+ të subvencionuar për zhvillimin e ideve inovatore me fookus tek dixhitalizimi dhe ekonomia mjedisore | | | 0 (2021) | 30 (2027) |
| **I.4.1. Nxitja e personave LGBTI+ të besojnë dhe aplikojnë për shërbimet e ofruara në fushën e punësimit dhe zhvillimit të sipërmarrjeve** | | **AKPA** | **AKAFP, AIDA, BDHTI, MFE,OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 - 6M-II- 2027** |
| I.4.1.a. Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve / broshurave informuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e ofruara nga shërbimet e punësimit dhe formimit profesional për punëkërkuesit e papunë | Fletëpalosjet e përgatitura dhe shpërndara nëpërmjet OJF-ve LGBTI+ (2000 copë) | AKPA | AKAFP, AIDA, BDHTI, MFE,OJF, org. ndërkombëtare | 6M-II- 2022 – 6M-II- 2022 |
| I.4.1.b. Bashkëpunimi me OJF e LGBTI+ për regjistrimin e personave LGBTI+ të papunë si punëkërkues të papunë pranë ZVP | Personat LGBTI+ në nevojë për punësim të evidentuar tek grupet e synuara | SHKP/ZVP | AKAFP, AKPA, MFE, OJF, MSHMS, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 - 6M-II- 2027 |
| I.4.1.c. Trajnimi i punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve të punësimit për të ofruar shërbime miqesore dhe pa diskriminim për personat LGBTI+ | 180 punonjëse dhe punonjës të trajhnuar çdo vit | SHKP/ZVP | AKAFP, AKPA, MFE, OJF, MSHMS, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 - 6M-II- 2027 |
| I.4.1.d. Subvencionimi i sipërmarrjeve të personave LGBTI+ që zbatojnë ide inovatore me fokus tek dixhitalizimi dhe ekonomia mjedisore. | 30 subvencionime të kryera | MFE | MBZHR, Min Shtet.Mbrojtjen e Sipërm, MIE Institucionet financiare qendrore, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2023 - 6M-II- 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi i Politikës II:** | **Garantimi i mbrojtjes dhe sigurisë për personat LGBTI+ përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, zbatimit efektiv të tij, si dhe rritjes së aksesit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë** | | | | |
| **Objektivi specifik II.1:** | **Përforcimi i mbrojtjes ligjore për personat LGBTI+ kundër krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës, nëpërmjet rishikimit dhe harmonizimit të legjilslacionit kombëtar me standardet evropiane/ndërkombëtare** | | | | |
| **Rezultati i pritshëm:** | i. Legjislacion i përmirësuar, veçanërisht për të siguruar ndalimin e gjuhës dhe krimit të urrejtjes si dhe dhunës ndaj personave LGBTI+. | | | | |
| **Treguesi** | II.1.a. Numri i propozimeve të dërguara dhe miratuara në lidhje me ndryshimet në legjislacionin civil dhe penal në RSH | | | Baseline:<br>Do përcaktohet deri në 2023 | Target:<br>3-5 ligje të rëndësishme civile dhe penale të përmirësuara (2027) |
| **II.1.1. Përmirësimi i legjislacionit penal për mbrojtje të personave LGBTI+ nga krimi i urrejtjes, gjuha e urrejtjes dhe dhuna (rishikimi i Kodit Penal)** | | | **MD** | **AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022<br>–<br>6M-II- 2024** |
| II.1.1.a. Analiza dhe rishikimi i Kodit Penal lidhur me sigurinë e personave LGBTI+ në përputhje me standartet evropiane (parashikimi si vepër penale i përdorimit të gjuhës diskriminuese ndaj personave LGBTI+), etj. | | Raporti i analizës me rekomandimet përkatëse për ndryshim | MD | AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022<br>–<br>6M-II- 2023 |
| II.1.1.b. Përgatitja e projekt propozimeve për përmirësimin e KP | | Projekt propoizimi i përgatitur i dorëezuar në Kuvend | MD | AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2024<br>–<br>6M-II- 2024 |
| III.1.1.c. Miratimi i projekt propozimeve | | KP i ndryshuar | Kuvendi | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2024<br>–<br>6M-II- 2024 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **II.1.2. Përmirësimi i legjislacionit familjar (Kodi i Familjes) duke konsideruar edhe të drejtën ndërkombëtare private për të rregulluar njohjen e lidhjeve familjare në situata ndërkufitare.** | | **MD** | **AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2024 – 6M-II- 2027** |
| II.1.2.a.Analiza dhe rishikimi i Kodit të Familjes për të siguruar të drejtat e martesës/bashkëjetesës për çiftet e së njëjtës gjini në baza të barabarta me çiftet e seksit të ndryshëm, regjimet pasurore, si dhe rishikimi i së Drejtës Ndërkombëtare Private për të rregulluar njohjen e lidhjeve familjare në situata ndërkufitare. | Raporti i analizës me rekomandimet përkatëse për ndryshim | MD | AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2024 – 6M-II- 2026 |
| II.1.2.b. Përgatitja e projekt propozimeve për përmirësimin e KF | Projekt propoizimi i përgatitur i dorëzuar në Kuvend | MD | AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2027 – 6M-II- 2027 |
| III.1.2.c. Miratimi i projekt propozimeve | KF i ndryshuar | Kuvendi | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2027 – 6M-II- 2027 |
| **II.1.3.Përgatitja e disa ligjeve të reja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave LGBTI+, si Ligji për Njohjen e Identitetit Gjinor, aktet nënligjore për mbrojtjen e personave interseks në Shqipëri, si dhe rishikimi i disa ligjeve ekzistuese.** | | **MSHMS** | **MD, AP, KMD, MB, OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 – 6M-II- 2027** |
| II.1.3.a. Përgatitja e një projekt ligji që siguron të drejtën për njohjen ligjore të gjinisë, dhe një ligji që mbron të drejtat e njeriut të personave interseks. | Proejkt ligji i përgatitur | MSHMS | MD, AP, KMD, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2024 – 6M-II- 2025 |
| II.1.3.b. Miratimi i projekt ligjit | Ligji i miratuar | Kuvendi | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2026 – 6M-II- 2026 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| II.1.3.c. Përmirësimi i Ligjit për Shëndetin Riprodhues, duke evidentuar në të qartësisht të drejtat njerësore të personave LGBTI+ | Proejkt ligji i përgatitur | MSHMS | MD, AP, KMD, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2023 |
| II.1.3.d. Miratimi i projekt ligjit | Ligji i miratuar | Kuvendi | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2023 – 6M-II- 2023 |
| **II.1.4. Përmirësimi i legjilsacionit në fushën e punësimit dhe përfshirja në të qartësisht e personave LGBTI+ si një grup që i përfiton të gjitha shërbimet e ofruara në fushën e punësimit dhe formimit profesional** | | **MFE** | **MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 – 6M-II- 2023** |
| II.1.4.a. Përgatitja e propozimeve për përmirësimin e Ligjit për Nxitjen e Punësimit. Miratimi, përditësimi dhe përafrimi i akteve nënligjore dhe rregulloreve te brendshme që mundësojnë fuqizimin ekonomik të personave LGBTI+. | Proejkt ligji i përgatitur | MFE | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2022 |
| II.1.4.b.Miratimi i projekt ligjit | Ligji i miratuar | Kuvendi | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2023 – 6M-II- 2023 |
| **II.1.5. Analiza, përgatitja dhe miratimi i ndryshimeve të tjera ligjore në përputhje dhe me standardet ( Ligjit për Azilin, Ligjit për Gjendjen Civile), etj** | | **MB** | **MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2023 – 6M-II- 2025** |
| II.1.5.a.Përgatitja e propozimeve për ndryshimet në ligjin për Azilin, si dhe Ligjin për Gjendjen Civile | Projekt ligjet e përgatitura | MB | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2023 – 6M-II- 2024 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|---|
| II.1.5.b.Miratimi i projekt ligjeve | | Ligjet e miratuara | Kuvendi | MD, AP, KMD, MSHMS, MB, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2025 – 6M-II- 2025 |
| **Objektivi specifik II.2:** | **Zbatimi me profesionalizem dhe pa paragjykime i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI+.** | | | | |
| **Rezultati i pritshëm:** | i. Profesioniste e profesionistë të drejtësisë dhe policimit më të përgatitur dhe të gatshëm për të mbrojtur të drejtat njerëzore të LGBTI+<br>ii. Rritja e besimit të personave LGBTI+ në sistemin e drejtësisë dhe të policimit | | | | |
| **Treguesi** | | | | Baseline: | Target |
| | II.2.a. Numri i raporteve vjetore të përpiluara dhe dorëzuara në Këshillin e Evropës, mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI+ | | | 0 (2021) | 6 (2027) |
| | II.2.b. Numri i personave të caktuar si pika fokale për LGBTI+ në PSHSH në nivel bashkie, të trajnuar | | | 0 (2021) | 61 (2027) |
| **II.2.1. Përgatitja e raportit mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI+, në përputhje me standardet ndërkombëtare sipas KE.** | | | **KMD** | **AP, MD, MB/PSHSH, Prokuroria e Pergjithshme, MSHMS, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 – 6M-II- 2027** |
| II.2.1.a. Mbledhja e të dhënave dhe përgatitja e raportit mbi diskriminimin dhe krimet e urrejtjes për personat LGBTI+ në Shqipëri | | Raporti vjetor i përgatitur | KMD | AP, MD, MB/PSHSH, Prokuroria e Pergjithshme, MSHMS, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2027 |
| II.2.1.b. Miratimi i raportit në GKZK dhe dorëzimi në KE | | Raporti i miratuar dhe i dorëzuar | KMD | AP, MD, MB/PSHSH, Prokuroria e Pergjithshme, MSHMS, NJVV, OJF, Org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **II.2.2 Krijimi i një mjedisi lehtësues për denoncimin e krimeve të urrejtjes dhe diskriminimit kundër personave LGBTI+ në ambjentet e PSHSH** | | **PSHSH** | **PSHSH, NJVV, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 – 6M-II- 2027** |
| II.2.2.a Caktimi i detyrës për marrjen dhe rregjistrimin e krimeve të urrejtjes dhe diskriminimit kundër personave LGBTI+, një specialisteje/specialisti në PSHSH në nivel bashkie (DVP dhe Komisariate) | 61 persona me detyrën e pikës fokale për LGBTI+ në nivel bashkie (DVP dhe Komisariate) | PSHSH | MB | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2027 |
| II.2.2.b. Trajnimi i këtyre pikave fokale në regjistrimin dhe trajtimin e raporteve të diskriminimit ndaj personave LGBTI+ dhe krimit të urrejtjes. | 61 pikat fokale të trajnuara | PSHSH | MB<br>Donatorë<br>Akademia e Sigurisë | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2027 |
| **II.2.3. Trajnimi i profesionisteve dhe profesionistëve të Zyrave për Ndihmë Juridike Falas, si dhe i OJF-ve dhe Klinikave të Ligjit të licensuara për ofrimin e ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e shërbimeve të ndjeshme ndaj personave LGBTI+** | | **MD / Drejtoria e Ndihmës JuridikeFalas** | **Dhoma Kombëtare e Avokatisë, KMD, AP, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 – 6M-II- 2027** |
| II.2.3.a. Përgatitja e modulit të trajnimit | Moduli i përgatitur | MD / Drejtoria e Ndihmës JuridikeFalas | Dhoma Kombëtare e Avokatisë, KMD, AP, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2022 |
| II.2.3.b. Trajnimi i profesionisteve dhe profesionistëve në fushën e ofrimit të ndihmës ligjore, për shërbime të ndjeshme ndaj pesonave LGBTI+ | 30 profesioniste e profesionistë të trajnuar çdo vit | MD / Drejtoria e Ndihmës JuridikeFalas | Dhoma Kombëtare e Avokatisë, KMD, AP, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2023 – 6M-II- 2027 |
| **II.2.4. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të PKV LGBTI+ 2021 - 2027** | | **MSHMS** | **Të gjitha institucionet përgjegjëse apo mbështetëse në zbatim** | **6M-I- 2022 – 6M-I- 2027** |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| III.2.4.a.Përgatitja e raporteve vjetore të monitorimit të zbatimit të PKV LGBTI+ 2021 - 2027 | Raporti vjetor i monitorimit i përgatitur | MSHMS | Të gjitha institucionet përgjegjëse apo mbështetëse në zbatim | 6M-I- 2022 – 6M-II- 2027 |
| III.2.4.b. Përgatitja e raportit të vlerësimit të ndërmjetëm të zbatimit të PKV LGBTI+ 2021 - 2027 | Raporti i vlerësimit i përgatitur | MSHMS | Të gjitha institucionet përgjegjëse apo mbështetëse në zbatim | 6M-I- 2025 – 6M-I- 2025 |
| III.2.4.c. Përgatitja e raportit të vlerësimit final ë zbatimit të PKV LGBTI+ 2021 - 2027 | Raporti i vlerësimit i përgatitur | MSHMS | Të gjitha institucionet përgjegjëse apo mbështetëse në zbatim | 6M-I- 2027 – 6M-I- 2027 |
| **Qëllimi i Politikës III:** | **Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jo-diskriminuese kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri** | | | |
| **Objektivi specifik III.1:** | **Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit kundrejt personave LGBTI+** | | | |
| **<u>Rezultatet e pritshme:</u>** | i. Një brez i ri më i hapur, jo paragjykues dhe pranues kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri | | | |
| **<u>Treguesit</u>** | | | Baseline: | Target: |
| | III.1.a. Numri i të rejave e të rinjve që pranojnë dhe nuk diskriminojnë personat LGBTI+ në Shqipëri | | Do përcaktohet në 2022 | Rritur me 2% cdo vit. |
| **III.1.1. Informimi dhe edukimi i vazhdueshëm i shoqërisë me parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe pranimit të personave LGBTI+ në Shqipëri** | | **MSHMS** | **KMD, AP, Ministritë e linjës, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare, mediat, akademia** | **6M-I- 2022 – 6M-I- 2027** |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| III.1.1.a. Zhvillimi i fushatës së përvitshme të ndërgjegjësimit publik në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë | 6 fushata kombëtare të përvitshme | MSHMS | KMD, AP, Ministritë e linjës, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare, mediat, akademia | 6M-I- 2022 – 6M-I- 2027 |
| III.1.1.b. Trajnimi i gazetareve dhe gazetarëve për të trajtuar me korrektësi dhe etikë çështjet e LGBTI+ në media | 30 gazetarë të trajnuar çdo vit | AMA | Fakulteti i Gazetarisë, KMD, AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-I- 2027 |
| III.1.1.c. Monitorimi i medias mbi thyerjen e etikës në trajtimin e çështjeve që lidhen me personat LGBTI+, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit të përdorur ndaj tyre, etj | 1 raport monirtorimi i përvitshëm | AMA | Fakulteti i Gazetarisë, KMD, AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-I- 2027 |
| III.1.1.d. Studim perceptimi (çdo 4 vjet) mbi qëndrimet e publikut ndaj personave LGBTI+ si dhe mbi vetë perceptimin e personave LGBTI+ mbi nivelin e pranueshmërisë së tyre nga ana e shoqërisë | Studimi i përgatitur me të dhënat mbi nivelin e pranimit të personave LGBTI+ në shoqëri | MSHMS | INSTAT, MD, AP, Ministritë e linjës, IAL, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-I- 2023 dhe 6M-I- 2026 – 6M-I- 2027 |
| III.1.1.e. Zhvillimi i një aktiviteti kulturor të përvitshëm me tematikë ose me në qendër personat LGBTI+ | Aktiviteti i zhvilluar çdo vit | Ministria e Kulturës | KMD, AP, Ministritë e linjës, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-I- 2027 |

| MASAT DHE AKTIVITETET | PRODUKTI | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | INSTITUCIONET PARTNERE | AFATI KOHOR |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik III.2:** **Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI+ midis punëdhënësve publikë e privatë.** | | | | |
| **Rezultatet e pritshme:** i. Një mjedis i punëdhënësish më miqësor dhe i hapur ndaj pranimit dhe punësimit të personave LGBTI+ | | | | |
| **Treguesit** III.2.a. Numri i ndërmarrjeve / kompanive / bizneseve që bashkohen me Kartën Kombëtare të Diversitetit. | | | Baseline<br>0 (2021) | Target:<br>50 (2027) |
| **III.2.1.Krijimi i një mjedisi punëdhënësish miqësor dhe pranues kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri** | | **MFE** | **Dhoma e Tregëtisë, KMD, AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare** | **6M-I- 2022 – 6M-II 2027** |
| III.2.1.a. Përgatitja dhe promovimi i një Karte Kombëtare të Diversitetit për punëdhënësit që të deklarohen si miqësorë ndaj personave LGBTI+. | Karta e përgatitur gati për nënshkrim | MFE | Dhoma e Tregëtisë, KMD, AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II 2022 |
| III.2.1.b. Informimi i biznesit privat dhe punëndhënësve në tërësi mbi rëndësinë e nënshkrimit të Kartës | 15 takime të realizuara me bizneset | MFE | Dhoma e Tregëtisë, KMD, AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II 2022 |
| III.2.1.c. Nënshkrimi i Kartës nga bizneset | Karta e nënshkruar nga 50 biznese | MFE | Dhoma e Tregëtisë, KMD, AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare | 6M-I- 2023 – 6M-II 2027 |
| III.2.1.d. Përgatitja dhe miratimi i një politike kundër diskriminimit të personave LGBTI+ në ambjentet e punës në institucionet shtetërore qendrore | Politika kundër diskriminimit të LGBTI+ e miratuar | Ministritë e linjës | KMD, AP, OJF, Org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II 2027 |
| III.2.1.e. Përgatitja dhe miratimi i një politike kundër diskriminimit të personave LGBTI+ në ambjentet e punës në institucionet shtetërore vendore | Politika kundër diskriminimit të LGBTI+ e miratuar | NJVV | KMD, AP, OJF, Org. ndërkombëtare | 6M-I- 2022 – 6M-II 2027 |

## ANEKS 5. PËRKUFIZIMET

| Termi | Kuptimi |
|---|---|
| LGBTI+ | Akronimi për "lezbike, gej, biseksual, transgjinor, interseks. etj", të cilat shpjegohen më tej në vijim. Duhet të kemi parasysh që, me kalimin e kohës dhe me zhvillimet që shoqëria dhe gjuha pëson, kjo listë akronimesh është pasuruar dhe zgjeruar. |
| Biseksual | Mbiemër mbi orientimin seksual, që përshkruan individët të cilët tërhiqen emocionalisht dhe seksualisht nga të dy sekset. Nuk supozon ose hamendëson jo-monogami. Disa njerëz identifikohen si "bi" në vend të biseksualë. |
| Gej | Mbiemër mbi orientimin seksual, që ka zëvendësuar gjerësisht fjalën "homoseksual" dhe përshkruan një burrë ose djalë fizikisht, seksualisht dhe emocionalisht i tërhequr nga një burrë os djalë tjetër. |
| Heteroseksuale/i drejtë | Term që përdoret për të përshkruar njerëzit që emocionalisht dhe fizikisht tërhiqen nga seksi i kundërt. |
| Heteroseksizëm | Qëndrime diskriminuese apo paragjykuese ndaj personave gej apo lesbike bazuar mbi përgjithësimin që heterosekualiteti është orientimi normal seksual. |
| Lezbike | Mbiemër mbi orientimin seksual, që përshkruan një grua ose vajzë e cila tërhiqet emocionalisht, fizikisht dhe seksualisht nga një grua ose vajzë tjetër |
| Personat transgjinorë ose njerëzit trans | Mbiemër që përshkruan një person identiteti gjinor dhe seksi i caktuar në lindje i të cilit, nuk korrespondojnë bazuar në pritshmëritë tradicionale. Për shembull, një person i caktuar seks femër në lindje i cili identifikohet si djalë/burrë, ose një person i caktuar seksi mashkull në lindje që identifikohet si vajzë/grua. Transgjinorët mund të përfshijnë edhe njerëz me identitete gjinore jashtë strukturës binare të gjinisë vajzë / grua dhe djalë / burrë. Pra termi transgjinor përdoret si një term ombrellë për personat që e ndjejnë ose e shprehin përkatësinë gjinore të tyre ndryshe nga pritshmëritë e shumicës që e bazojnë në seksin e tyre biologjik. Ky grupim mund të përfshijë edhe personat ***transeksualë*** (një term i përdorur ndonjëherë në literaturën mjekësore ose nga disa persona transgjinorë për të përshkruar personat të cilët kanë kaluar nëpër procesin e trajtimeve mjekësore përmes marrjes së hormoneve apo ndërhyrjeve kirurgjikale për të njohur, pranuar dhe reflektuar siç e ndiejnë identitetin e tyre gjinor), ose dhe për personat të cilët ***vishen 'ndryshe'*** (njerëz që vishen me veshje stereotipike të seksit tjetër, por të cilët nuk kanë ndërmend të ndryshojnë përkatësinë gjinore të tyre nga pritshëmritë tradicionale të lidhura me seksin e caktuar që në lindje. |
| Seksi biologjik | Përfshin të gjitha aspektet e strukturës biologjike të tij të lidhur me gjininë: jo vetëm organet gjenitale, por edhe sistemin e brendshëm riprodhues, kromozomet dhe karakteristikat dytësore seksuale të tilla si gjinjtë, qimet në fytyrë apo në trup, zërin dhe formën trupore. Seksi biologjik i shumicës së njerëzve është qartësisht dhe në mënyrë konsistente femër apo mashkull.<br>Megjithatë, një numër i vogël, por i rëndësishëm, njerëzish kanë trupa, të cilat nuk janë plotësisht mashkull apo femër. Njerëzit e lindur me këto lloj variacionesh quhen njerëz me seks të ndërmjetëm. Një person mund të ketë edhe një seks biologjik, i cili nuk është plotësisht i qartë si mashkull apo femër nëqoftëse i është nënshtruar një ndërhyrjeje hormonale apo kirurgjikale si pjesë e një procesi të ricaktimit të gjinisë. |
| Misgendering (keqpërcaktim i përkatësisë gjinore): | Situata kur një ofrues shërbimi aludon përkatësinë gjinore të gabuar për një person, me apo pa dashje. |
| Ndërseksionaliteti | Ideja që identitetet gjithëpërfshirëse ndikohen dhe formësohen nga ndërlidhja e racës, klasës, etnisë, orientimit seksual, gjinisë, identiteti gjinor, paaftësisë fizike, origjinës kombëtare, fesë, moshës dhe atributeve të tjera shoqërore ose fizike. Ndërveprimi midis kategorizimeve sociale të ndryshme të lidhura me racën, statusin shoqëror, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor që çojnë në një mbivendosje të mundësive për të përjetuar diskriminim apo për të qënë i dizavantazhuar, për shembull kur një person i përket etnisë Rome dhe është LGBTI+ |

| | |
|---|---|
| ersonat ndërseksuale/ Interseks | Term i përgjithshëm që përdoret për kushte të ndryshme kur një person lind me një anatomi të caktuar seksuale dhe të organeve të riprodhimit që nuk përputhet me percaktimin tipik mashkull/femër. Përshkruan një grup të situatave të lindura në të cilat organet riprodhuese, organet gjenitale dhe / ose anatomia tjetër seksuale nuk zhvillohen sipas pritjeve tradicionale për femra ose meshkuj. Intersex gjithashtu mund të përdoret si një term identiteti për dikë me një nga këto situata (komuniteti mjekësor nganjëherë përdor edhe termin "ndryshime të zhvillimit të seksit" në vnd të "interseks") |
| Gjinia e përftuar | Është një term i përdorur për të kuptuar rolin gjinor në të cilin ka kaluar një person për ta jetuar jetën dhe i cili përputhet me identitetin gjinor të vetë-perceptuar prej këtij personi. Prandaj, gjinia e përftuar e një gruaje trans, mashkull në femër, është femërore. Gjinia e përftuar e një burri trans, femër në mashkull, është mashkullore. |
| Orientimi gjinor | Përdoret për të përshkruar gjininë (gjinitë) ndaj të cilës (cilave) një person tërhiqet emocionalisht dhe fizikisht. Për shembull, një person që tërhiqet nga seksi i kundërt e përshkruan orientimin gjinor si të drejtë. |
| Paragjykimi | Përshkruan rastet kur njerëzit krijojnë bindjet e tyre për njerëz të tjerë ose një grup njerëzish në baza irracionale, pa i njohur ata, apo pa mësuar rreth tyre më parë. Kjo mund të nënkuptojë që dikush nuk e pëlqen ose urren një grup të tërë njerëzish. |
| Diskriminimi | Është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilido shkak të përmendur në Nenin 1 të Ligjit 'Për mbrojtjen nga diskriminimi" (në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër), që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe ligjet në fuqi. |
| Diskriminimi kulturor Heterocentrizmi & Heteronormativizmi | Heterocentrizmi dhe heteronomativizmi janë terma që përshkruajnë gamën e besimeve kulturore, supozimeve dhe mënyrave të zakonshme të të menduarit dhe vepruarit, që i zhvlerësojnë dhe marxhinalizojnë personat LGBTIQ dhe përvojat e tyre. Heterocentrizmi mund të përfshijë: supozimin se të giithë njerëzit janë ose duhet të jenë heteroseksuale: besimin se marrëdhëniet heteroseksuale janë automatikisht superiore dhe më të dëshirueshme se sa marrëdhëniet me persona të të njëjtit seks, si dhe stereotipe dhe mite, të cilat i denigrojnë personat LGBTIQ. |
| Diskriminimi strukturor Heteroseksizmi | Heteroseksizmi është një sistem diskriminimi i cili u mohon të drejtat dhe liritë personave LGBTIQ dhe që mishëron superioritetin e heteroseksualitetit në ligje dhe politika publike. Kjo mund të përfshijë mosha të pabarabarta pëlqimi ose edhe shpallje të homoseksualitetit si të paligjshëm në disa vende dhe shtete, të drejta të kufizuara ose të mohuara partneriteti për çiftet me të njëjtin seks, dhe ligje që konkretisht i ndalojnë liritë e personave LGBTIQ. |
| Diversitet | Parimi që cilido person është i veçantë dhe pranimi i diferencave në terma të racës, etnicitetit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit socio-ekonomik, moshës, aftësive fizike, besimeve fetare, ideologjive politike dhe ideologjive të tjera. |
| Queer | Është një fjalë që njerëzit e përdorin për të përshkruar identitetin e tyre gjinor i cili nuk konformohet me standartet sociale dhe normat tradicionale të gjinisë. Queer mund të vetëquhen personat gej, lesbike, biseksual, straight etj. |
| Homofobi | Ky term i referohet frikës, zemërimit, urrejtjes, mostolerimit dhe mospranimit të personave LGBTI+. |
| Homofobi e brendësuar (interiorizuar) | Homofobia e brendësuar dhe shtypja ndodh tek personat homoseksual, lezbike, biseksualë, dhe madje edhe heteroseksualëve, të cilëve i është mësuar se heteroseksualiteti është normë dhe "mënyra e saktë e të qënurit". Personat LGBTI+ në disa raste përvetësojnë mesazhet negative që pjesa tjetër e shoqërisë projekton ndaj tyre. Disa persona LGBTI+ vuajnë nga shqetësime mendore, si rezultat i kësaj. |

| | |
|---|---|
| Dalja hapur (coming out) | Procesi i njohjes, ndërgjegjësimit dhe pranimit të orientimit jo-heteroseksual ose identitetit gjinor me veten dhe pastaj ndarja me të tjerët. Dalja hapur zakonisht ndodh me etapa, dhe është një proçes jo linear. |
| SOGIESC | Një term ombrellë më e gjerë sesa LGBTI+ që nënkupton "Orientimi seksual, Identiteti dhe Shprehja Gjinore, dhe Karakteristikat e Seksit", të cilat veç shtjellimit të mësipërm, mund të përmblidhen më thjesht si në vijim: ndërsa orientimi seksual është në vetvete një markues që identifikon tërheqjen e qëndrueshme romantike, emocionale dhe seksuale, identiteti gjinor është një koncept i brendshëm për vetveten si mashkull ose si femër, ose për disa individë si një ndërthyrje e të dyjave, ose e asnjërës (pra mënyra si individi e koncepton veten, koncept që mund të jetë i ndryshëm nga gjinia/seksi që e shoqëron në dokumenta ligjorë). Shprehja gjinore nga ana tjetër, është një sjellje e individit për t'u komunikuar jashtë vetes. Eshtë mënyra si individi zgjedh ta bëjë të ditur identitetin e vet, përmes sjelljes, veshjes, modelit të flokëve, apo zërit, dhe që mund ose mund të mos përputhet me normat apo sjelljet e përkufizuara sociale që kërkojnë një pozicionim strikt ose mashkullor, ose femëror. Së fundmi, "karakteristikat e seksit" është një togfjalësh që synon të identifikojë personat që lindin me karakteristika primare dhe dytësore seksuale të ndryshme nga ato të femrës apo mashkullit (personat interseks). |
| Dimensionet e "përkatësisë gjinore"[20]. | Njerëzit kanë tendencë të përdorin termat "seks" dhe "përkatësi gjinore" në mënyrë të njëjtë apo si zëvendësim i njëri-tjetrit. Por, ndërsa janë të lidhur, të dy termat nuk janë ekuivalentë. Në përgjithësi, ne caktojmë seksin e një të porsalinduri.porsalindure si mashkull apo femër, bazuar në organet gjenitale të foshnjës. Pasi caktohet një seks, ne supozojmë përkatësinë gjinore të fëmijës. Për disa njerëz, kjo gjë nuk përbën ndonjë shqetësim apo mendim të mëtejshëm, sepse përkatësia gjinore e tyre përputhet me idetë dhe supozimet e lidhura me seksin e tyre. Sidoqoftë, ndërsa përkatësia gjinore mund të fillojë me caktimin e seksit tonë, në fakt nuk mbaron këtu. Përkatësia gjinore e një personi është ndërlidhja e ndërlikuar midis tre dimensioneve: trupit, identitetit gjinor dhe përkatësisë gjinore sociale. |
| Trupi | Shumica e shoqërive e shikojnë seksin si një koncept binar, me dy mundësi të fiksuara në mënyrë të ngurtë: mashkull ose femër, bazuar në anatominë dhe funksionet riprodhuese të një personi. Por një pamje binare e seksit nuk arrin të kapë as aspektin biologjik të gjinisë. Ndërsa shpesh na mësojnë se trupat kanë një nga dy format e organeve gjenitale, të cilat klasifikohen si "femra" ose "mashkull", ka tipare të Interseksit që demonstrojnë se seksi ekziston përmes një vazhdimi të mundësive. Ky spektër biologjik në vetvete duhet të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë idenë e thjeshtëzuar se ekzistojnë vetëm dy gjini. Marrëdhënia midis gjinisë së një personi dhe trupit të tij shkon përtej funksioneve riprodhuese të dikujt. Kërkimet në neurologjinë, endokrinologjinë dhe biologjinë qelizore tregojnë për një bazë më të gjerë biologjike për përvojën e një individi mbi përkatësinë gjinore. Në fakt, kërkimet gjithnjë e më shumë tregojnë se truri ynë luan një rol kryesor në mënyrën se përjetojmë përkatësinë gjinore tonë. Vetë trupat gjithashtu janë gjinor në kontekstin e pritjeve kulturore. Mashkullorësia dhe feminiliteti barazohen me atribute të caktuara fizike, duke na etiketuar si pak a shumë një burrë/djalë dhe grua/vajzë bazuar në shkallën në të cilën ato atribute janë të pranishme. Kjo gjini e trupave tanë ndikon në mënyrën se si ndihemi për veten tonë dhe se si të tjerët na perceptojnë dhe bashkëveprojnë me ne. |

[20] Bëhet fjalë për termin "gender" – "gjini", por në Shqipëri prej vitesh nuk është përdorur saktësisht si terminologji, pasi vetë ky term ka zëvendësuar më shumë termin "seks" (pra është përdorur zakonisht "Gjinia" = mashkull/ femër) Prandaj, për të bërë dallimin mes tij dhe asaj që në sintaksë e kemi formuluar si "mashkullore" apo "femërore" (duke e emërtuar sërish "gjini") si dhe "mashkullorësisë" e "feminilitetit" që shoqëron konceptet e djalë/burrë apo vajza/grua, ekspertet/ekspertët e fushës, prej vitesh kanë dakordësuar që në çështjet e barazisë gjinore, termin "gender" ta përkthejnë "përkatësi gjinore"

**Identiteti gjinor**

Identiteti gjinor është përvoja jonë e brendshme dhe emërtimi i përkatësisë gjinore tonë. Mund të korrespondojë ose ndryshojë nga seksi që na është caktuar në lindje. Kuptimi i gjinisë sonë vjen për shumicën prej nesh mjaft herët në jetë. Identiteti gjinor është një aspekt i qenësishëm i përbërjes së një personi. Individët nuk zgjedhin gjininë e tyre dhe as nuk mund ta ndryshojnë atë. Sidoqoftë, fjalët që dikush përdor për të komunikuar identitetin e tyre gjinor mund të ndryshojnë me kalimin e kohës; emërtimi i gjinisë së dikujt mund të jetë një çështje komplekse dhe në zhvillim. Për shkak se ne kemi një gjuhë të kufizuar për përkatësinë gjinore, një personi mund t'i duhet mjaft kohë për të zbuluar, ose krijuar, gjuhën që komunikon më së miri përvojën e tij të brendshme. Po kështu, ndërsa gjuha evoluon, emri i një personi për përkatësinë gjinore të tij gjithashtu mund të zhvillohet. Kjo nuk do të thotë se gjinia e tij ka ndryshuar, por përkundrazi fjalët për të po ndryshojnë. Dy identitetet gjinore me të cilët njerëzit janë të njohur janë djem/burra dhe vajza/gra dhe shpesh njerëzit mendojnë se këto janë identitetet e vetme gjinore. Kjo ide se ekzistojnë vetëm dy gjini - dhe që secili individ duhet të jetë ose njëra ose tjetra - quhet "Binari Gjinore". Sidoqoftë, gjatë gjithë historisë njerëzore ne e dimë se shumë shoqëri kanë parë, dhe vazhdojnë ta shohin, gjininë si një spektër, dhe jo të kufizuar në vetëm dy mundësi. Përveç këtyre dy identiteteve, identitetet e tjera tani janë të zakonshme. Të rejat dhe të rinjtë sot nuk ndihen më të lidhur nga binari gjinor, në vend të kësaj krijojnë një fjalor në rritje për përkatësinë gjinore. Më shumë sesa thjesht një seri fjalësh të reja, megjithatë, ky ndryshim në gjuhë përfaqëson një kuptim shumë më të nuancuar të përvojës së vetë gjinisë. Termat që komunikojnë gamën e gjerë të përvojave të njerëzve jo binarë janë veçanërisht në rritje në numër. "Genderqueer", një term që përdoret si identitet ashtu edhe si term ombrellë për identitetet jo binare, është një shembull i një termi për ata që nuk identifikohen si ekskluzivisht mashkullorë apo femërore. Ky evolucion i gjuhës është emocionues, por gjithashtu mund të jetë konfuz pasi termat e rinj krijohen rregullisht, por ajo çfarë nënkuptojnë, mund të ndryshojë nga personi në person.

**Përkatësia gjinore sociale**

Është dimensioni i tretë. Kjo përfshin shprehjen gjinore, e cila është mënyra se si ne u komunikojmë gjininë tonë të tjerëve përmes gjërave të tilla si veshjet, modelet e flokëve dhe mënyrën e të vepruarit. Gjithashtu përfshin mënyrën se si individët, komunitetet dhe shoqëria perceptojnë, bashkëveprojnë dhe përpiqen të formojnë përkatësinë gjinore tonë. Përkatësia gjinore sociale përfshin rolet dhe pritjet gjinore dhe mënyrën se si shoqëria i përdor ato në përpjekje për të zbatuar konformitetin me normat aktuale gjinore. Praktikisht gjithçkaje i caktohet një gjini - lodrat, ngjyrat dhe rrobat janë disa nga shembujt më të qartë. Ne fillojmë t'i mësojmë fëmijët për gjininë që nga momenti kur ata lindin: duke pasur parasysh prevalencën e binarit gjinor, fëmijët përballen me presion të madh për të shprehur përkatësinë e tyre gjinore brenda përkufizimeve të ngushta, stereotipike të "djalit" ose "vajzës". Pritjet në lidhje me gjininë komunikohen përmes çdo aspekti të jetës sonë, përfshirë familjen, kulturën, bashkëmoshatarët, shkollat, komunitetin, median dhe fenë. Rolet dhe pritjet gjinore janë aq të ngulitura në kulturën tonë sa është e vështirë të imagjinosh gjërat në ndonjë mënyrë tjetër. Fëmijët që shprehin përkatësi gjinore jashtë këtyre normave shoqërore shpesh kanë një përvojë të vështirë. Vajzat që mendohen si shumë mashkullore dhe djemtë që shihen si femra përballen me një sërë sfidash. Fëmijët që nuk shprehen përgjatë vijave binare gjinore shpesh bëhen të padukshëm ose drejtohen në një prezantim më binar të gjinisë. Presionet për t'u përshtatur në shtëpi, keqtrajtimi nga bashkëmoshatarët në shkollë dhe dënimi nga shoqëria e gjerë janë vetëm disa nga përpjekjet me të cilat përballet një fëmijë, shprehja e të cilit nuk bie në përputhje me sistemin binar gjinor. Për shkak se pritjet rreth përkatësisë gjinore janë kaq të ngurta, ne shpesh supozojmë se ajo që dikush vesh, ose mënyra se si lëvizin, flasin ose shprehen, na tregon diçka për identitetin e tyre gjinor. Por shprehja është e dallueshme nga identiteti - ne nuk mund të supozojmë identitetin gjinor të një personi bazuar në shprehjen e tij gjinore. Për shembull, një djalë mund të dëshirojë të veshë funde ose fustane. Zgjedhja e tij në veshje nuk përcakton identitetin e tij gjinor; kjo thjesht do të thotë që ai preferon (të paktën disa herë) të veshë rroba që shoqëria zakonisht i ka lidhur me vajzat. Në fakt, mënyra se si ne interpretojmë gjininë e një personi dhe supozimet që ne bëjmë rreth tyre ka të bëjë me kuptimin tonë personal të përkatësisë gjinore dhe normave e stereotipeve që kemi integruar - nuk ka të bëjë me ta. Së fundmi, normat rreth gjinisë ndryshojnë në të gjitha shoqëritë dhe me kalimin e kohës.

Përkatësia gjinore personale.

Ndërsa dimensionet e gjinisë dhe dëshira për përputhshmëri janë të zakonshme për të gjithë ne, në fund të fundit përkatësia gjinore është personale. Çdo dimension i gjinisë informohet nga kryqëzimi ynë unik i identiteteve, përvojave dhe karakteristikave personale. Ne jemi më shumë sesa trupi ynë, identiteti gjinor dhe shprehja gjinore: ne jemi gjithashtu raca, etnia, klasa, besimi, ndjenja e vendit gjeografik, historia familjare dhe më shumë. Përkatësia gjinore jonë është personale sepse, ndërsa ne ndajmë disa nga këto aspekte të vetvetes me të tjerët, mënyra se si bashkohen të gjitha këto identitete, ndikime dhe karakteristika është unike për secilin prej nesh.

Përkatësia gjinore është e ndryshme nga orientimi seksual.

Një dallim përfundimtar për të bërë është ndryshimi midis përkatësisë gjinore dhe orientimit seksual, të cilat shpesh janë të ndërthurura gabimisht. Në fakt, përkatësia gjinore dhe orientimi seksual janë dy aspekte të veçanta, por të lidhura, të vetvetes. Përkatësa gjinore është personale (si e shohim veten), ndërsa orientimi seksual është ndërpersonale (cili/cila na tërheq fizikisht, emocionalisht dhe / ose romantikisht). Pse është kaq kritike të bëhet dallimi midis këtyre dy koncepteve? Kur ngatërrojmë përkatësinë gjinore me orientimin seksual, ka të ngjarë të bëjmë supozime për një person që nuk kanë asnjë lidhje me atë që është. Për shembull, kur shprehja gjinore e dikujt nuk është në përputhje me pritjet e të tjerëve, shpesh bëhen supozime për orientimin seksual të atij personi. Djali i cili pëlqen të luajë princeshën supozohet të jetë homoseksual dhe vajza që ble rroba në seksionin "djem" dhe favorizon një prerje të shkurtër të flokëve mund të supozohet se është lezbike. Këto mund të jenë përfundime të gabuara. Ajo që dikush vesh dhe si vepron ka të bëjë me shprehjen gjinore. Bashkimi shoqëror i përkatësisë gjinore dhe orientimit seksual gjithashtu mund të ndërhyjë në aftësinë e dikujt për të kuptuar dhe artikuluar aspektet e përkatësisë gjinore. Të menduarit për këto dy aspekte të vetvetes si të këmbyeshëm mund, në vend që të na ndihmojë të njohim veten dhe njëri-tjetrin më mirë, në të vërtetë të na pengojë në kuptimin dhe komunikimin. Përmes një shqyrtimi të kujdesshëm të veçantisë dhe vlefshmërisë së përvojës së secilit prej vetes, ne mund të zhvillojmë një pranim më të madh për të gjithë. Jo vetëm që kjo do të krijojë një përfshirje më të madhe për individët që sfidojnë normat e gjinisë, por do të krijojë hapësirë për të gjithë individët për të eksploruar dhe shprehur më plotësisht se cilët janë.